



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës (Komuna e Prishtinës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prishtinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Në dy raste, obligimet e papaguara ishin paraqitur dy herë në PVF, duke rezultuar në mbivlerësim të detyrimeve për shumën prej 164,851€.
- B1 Llogaritë e arkëtueshme në PFV ishin mbivlerësuar për 680,021€.
- B2 Në 52 raste, në vlerë totale prej 7,766,370€, shpenzimet ishin klasifikuar në kategori ekonomike jo adekuate, përfshirë pagesa nga vendime gjyqësore/përmbartimore dhe pagesa tjera të realizuara nga Komuna, duke ndikuar në paraqitjen e saktë të shpenzimeve në PVF.
- B3 Detyrimet kontingjente në PVF ishin mbivlerësuar për 27,289,835€, si rezultat i prezantimit jo të saktë të lëndëve gjyqësore.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Prishtinës nuk kanë qenë në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Komuna kishte vonesa në ekzekutimin e vendimeve për ankesat e tatimpaguesve, duke ndikuar në evidentim jo të saktë të detyrimeve tatimore.
- A3 Në tri raste kemi identifikuar gabime në llogaritjen e tarifave për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, si rezultat i aplikimit jo të saktë të tarifave dhe koeficientëve të përcaktuar me rregullore.
- A4 Komuna nuk kishte siguruar monitorim dhe dokumentim të mjaftueshëm lidhur me realizimin dhe ndryshimet në fushëveprim të projektit të realizuar me UNDP-në, si dhe kishte lejuar shfrytëzimin e pronës komunale pa procedurat dhe aprovimet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe pa siguruar përfitime të qarta financiare apo institucionale për Komunën.
- A5 Në një kontratë për shërbime, një pjesë e shërbimeve ishte realizuar nga operator ekonomik që nuk ishte pjesë e kontratës dhe nuk ishte aprovuar sipas procedurave të parapara për nënkontraktim.
- A6 Në një rast, është përdorur kontratë kornizë me çmime të poentuara, por njëkohësisht është përfshirë edhe pragu $\pm 30\%$, në kundërshtim me rregulloren e prokurimit publik.
- B4 Komuna në tri raste kishte hyrë në obligime kontraktuale për realizimin e projekteve kapitale pa pasur fonde të mjaftueshme të parapara në Ligjin e Buxhetit.
- B5 Komuna në dy raste kishte filluar procedurat e prokurimit dhe kishte hyrë në obligime kontraktuale për realizimin e projekteve kapitale para sigurimit të lejeve, pëlqimeve dhe kushteve të nevojshme administrative e ligjore për realizimin e punimeve, duke rezultuar me pezullim të punimeve.
- B6 Kemi identifikuar vonesa në pagesën e faturave përtej afatit ligjor prej 30 ditësh, në 42 raste të testuara në vlerë totale prej 8,165,530€.
- B7 Komuna në 46 raste kishte realizuar pagesa të investimeve kapitale në vlerë prej 10,192,709€, përmes marrjes së mjeteve nga projekte të tjera kapitale pa aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal, në kundërshtim me kërkesat ligjore për ndryshimet buxhetore dhe menaxhimin e investimeve kapitale.
- B8 Në gjashtë raste kemi vërejtur vonesa në realizimin e projekteve kapitale krahas afateve të përcaktuara me kontratë dhe plan dinamik.
- B9 Në katër raste janë evidentuar ndryshime në pozicionet e kontratës, përmes rritjes apo zvogëlimit të sasive të kontraktuara, pa siguruar paraprakisht aprovimet e nevojshme sipas kërkesave të rregullave të prokurimit publik.

- C1 Në një rast, Komuna kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik edhe pse oferta përmbante gabime aritmetike në paramasë dhe paralogari, të cilat tejkalonin pragun e lejuar prej +/-2% të përcaktuar me rregullore. Përkundër kësaj, komisioni i vlerësimit nuk kishte trajtuar gabimet sipas kërkesave ligjore dhe kontrata ishte nënshkruar bazuar në vlerën e pakorrigjuar të ofertës.
- C2 Komuna kishte financuar një OJQ në vlerë prej 40,000€ pa zbatuar procedurën e thirrjes publike, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores MF-nr. 04/2017 për financimin publik të OJQ-ve.
- C3 Në një kontratë publike kornizë me çmime për njësi, vlera e shpenzuar për një kategori të caktuar ka tejkaluar limitin e lejuar sipas peshimit të përcaktuar në kontratë

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prishtinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prishtinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prishtinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prishtinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prishtinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit janë identifikuar çështje që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë më shumë vëmendje lidhen me çështjet me ndikim në opinionin financiar, kryesisht për shkak të paraqitjes jo të saktë dhe jo të plotë të Pasqyrave Vjetore Financiare. Mangësitë e identifikuar përfshijnë mbivlerësimin e obligimeve të papaguara, detyrimeve kontigjente dhe llogarive të arkëtueshme.

Po ashtu, në fushën e shpenzimeve janë evidentuar raste të klasifikimit jo adekuat të shpenzimeve dhe shpërndarje jo të drejtë të pagesave të tatimpaguesve, duke ndikuar në paraqitjen e saktë të të dhënave financiare. Komuna gjatë vitit 2025 është përballur edhe me vështirësi financiare si rezultat i vlerës së lartë të pagesave të realizuara përmes vendimeve gjyqësore. Deri më 31.12.2025, vlera e këtyre pagesave kishte arritur në 45,691,077€, duke ndikuar në menaxhimin e buxhetit dhe realizimin e obligimeve tjera financiare.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, gjatë auditimit janë identifikuar mangësi në menaxhimin e proceseve financiare, prokurimit publik dhe investimeve kapitale. Çështjet kryesore lidhen me vonesa në ekzekutimin e vendimeve për ankesat e tatimpaguesve dhe pagesave gjyqësore, aplikim jo të saktë të tarifave për leje ndërtimore, dobësi në paraqitjen reale të borxheve të paarkëtuara, si dhe dobësi në menaxhimin dhe zbatimin e kontratave publike. Po ashtu, janë evidentuar raste të hyrjes në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme, ndryshime buxhetore pa aprovimet e nevojshme, fillim të procedurave të prokurimit pa sigurimin paraprak të lejeve ndërtimore, vonesa në realizimin e projekteve kapitale, si dhe subvencionim të OJQ-ve pa thirrje publike.

Tek çështjet tjera të menaxhimit financiar janë evidentuar mangësi në funksionimin e kontrolleve të brendshme, pasaktësi në regjistrimin, klasifikimin dhe prezantimin e pasurive, dobësi në inventarizimin e pasurisë dhe arkëtimin e borgjeve, si dhe mangësi në zbatimin dhe monitorimin e projekteve kapitale.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim korrigjimin e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, përfshirë shpalosjet në shënimet shpjeguese, si dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme dhe pajtueshmërisë me kërkesat ligjore në menaxhimin e fondeve publike.

Ky raport ka rezultuar me 25 rekomandime, nga të cilat 14 janë rekomandime të përsëritura, tri rekomandime janë pjesërisht të zbatuara, tetë janë rekomandime të reja, ndërsa dy rekomandime janë zgjidhur gjatë procesit të auditimit. Ne do t'i përcjellim këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mbivlerësimi i obligimeve të papaguara si rezultat i paraqitjes së dyfishtë në PVF

Gjetja Sipas nenit 17, pika 1 të Rregullores MF nr. 01/2017, Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat, shërbimet apo punët e realizuara të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga pranimi i faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata buxhetore.

Po ashtu, sipas pikës 3 të të njëjtit nen, organizatat buxhetore duhet të raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) e krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Gjatë auditimit kemi konstatuar se në dy raste, obligime të papaguara në vlerë totale prej 164,851€ ishin paraqitur dy herë në PVF. Si rezultat, detyrimet e papaguara të institucionit ishin mbivlerësuar për të njëjtën shumë.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontroleve efektive gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare dhe mosverifikimit të duhur të të dhënave para finalizimit të PVF-ve.

Ndikimi Paraqitja e dyfishtë e obligimeve të papaguara ka ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve totale dhe në paraqitjen jo të saktë të gjendjes financiare në PVF.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontroleve efektive gjatë përgatitjes së PVF-ve, në mënyrë që obligimet e papaguara të verifikohen dhe harmonizohen para finalizimit të pasqyrave financiare, duke shmangur paraqitjen e dyfishtë dhe mbivlerësimin e detyrimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B1 - Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme në PFV**

Gjetja Bazuar në Rregulloren Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16 përcakton se "Organizatrat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave".

Llogaritë e arkëtueshme në PFV ishin mbivlerësuar për 680,021€, si rrjedhojë e prezantimit të pasaktë të borgjeve të paarkëtuara, si në vijim:

- Në katër raste janë ngarkuar "Parcela me tatim në pronë në emër të institucionit të Komunës së Prishtinës" në vlerë 601,901€ në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 10, pika 1.1 ku përcaktohet se Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të "Institucioneve publike të Republikës së Kosovës", dhe si pasoj kanë ndikuar në mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme në PFV; dhe

- Në dy raste "Taksat për rregullimin e infrastrukturës" janë dyfishuar borgjet për 78,120€ duke mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme në PFV.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme për përmirësimin e regjistrave të llogarive të arkëtueshme, raportimin e drejtë dhe shpalosjen e tyre në PFV.

Ndikimi Prezantimi jo i saktë i llogarive të arkëtueshme ndikon në pasqyrim jo të drejtë të gjendjes financiare dhe rrit rrezikun që të hyrat të mos menaxhohen dhe monitorohen në mënyrë adekuate.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim të përmirësimit të procesit të menaxhimit dhe raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

Gjetja Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, neni 15 parasheh që në rastin e komunës, ndarjet buxhetore nga "Rezerva" me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Këto mjete duhet të merren brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me qarkore (pika 3, paragrafi i fundit), përjashtimisht mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Ndërsa, Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël.

Nga mostrat e testuara, kemi identifikuar keqklasifikime në 52 pagesa, në vlerë totale prej 7,766,370€.

a) Prej tyre, 24 pagesa në vlerë 3,331,736€ kishin të bënin me obligime nga vendime gjyqësore/përmbartimore, të cilat, për shkak të mungesës së planifikimit të mjaftueshëm të fondeve rezervë, ishin mbuluar nga kategori tjera buxhetore. Në kuadër të këtyre pagesave: në 14 pagesa, në vlerë totale prej 2,546,151€, obligimet nga kontrata kolektive (paga jubilarë dhe shujta) ishin ekzekutuar nga kategori jo adekuate, prej të cilave: dy pagesa në vlerë 466,712€ nga investimet kapitale; 11 pagesa në vlerë 1,944,994€ nga mallrat dhe shërbimet; dhe një pagesë në vlerë 134,445€ nga subvencionet dhe transferet.

Përpos këtyre, janë identifikuar edhe pagesa për kategoritë tjera joadekuate që kishin shkaktuar keqklasifikimin e shpenzimeve e që janë: në një rast, në vlerë 69,084€, nga mallrat dhe shërbimet ishte paguar për investime kapitale; në tetë raste, në vlerë 628,422€, nga investimet kapitale ishte paguar për mallra dhe shërbime; dhe në një rast, në vlerë 88,080€, nga subvencionet ishte paguar për mallra dhe shërbime.

b) Gjithashtu, në 28 raste tjera, në vlerë totale prej 4,434,634€, pagesat e realizuara nga Komuna nuk lidheshin me vendime gjyqësore, por ishin klasifikuar në kategori ekonomike jo adekuate. Konkretisht: në 18 raste, në vlerë 3,218,054€, nga investimet kapitale ishin paguar mallra dhe shërbime; në shtatë raste, në vlerë 1,003,182€, nga investimet kapitale ishin paguar

subvencione dhe transfere; në një rast, në vlerë 43,990€, nga mallrat dhe shërbimet ishte paguar për investime kapitale; dhe në dy raste, në vlerë 169,458€, nga subvencionet dhe transferet ishin paguar mallra dhe shërbime.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së buxhetit të mjaftueshëm për mbulimin e obligimeve nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, si dhe mungesës së kontrolleve efektive në klasifikimin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike përkatëse.

Ndikimi

Si rezultat, shpenzimet në vlerë 7,766,370€ nuk janë prezantuar në kategoritë përkatëse ekonomike, duke ndikuar në paraqitjen jo të drejtë të ekzekutimit të buxhetit në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që me rastin e përgatitjes së buxhetit të mirren parasysh kërkesat e Ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të lëshuara nga MFTP si dhe të forcojë mekanizmat e kontrollit për klasifikimin dhe regjistrimin e saktë të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontingjente në PVF

Gjetja

Sipas nenit 18 të Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore, në harmoni me LMFPN-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Gjatë auditimit të detyrimeve kontingjente kemi vërejtur se vlera e raportuar në PVF ishte mbivlerësuar për 27,289,835€. Konkretisht, detyrimet kontingjente ishin mbivlerësuar për 27,541,083€, ndërsa në anën tjetër ishin nënvlerësuar për 251,248€, për shkak të rasteve si në vijim:

- Në tri raste, vlerat e paraqitura si detyrime kontingjente nuk ishin të sakta, ku në dy prej tyre kishte mbivlerësim prej 52,500€, ndërsa në një rast kishte nënvlerësim prej 251,248€;
- në një rast, në vend të vlerës 227,067€, ishte raportuar vlera 22,706,748€, duke shkaktuar mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për 22,479,681€;
- në dy raste, në vlerë prej 3,548,368€, paditë ishin tërhequr nga paditësit, megjithatë ato ende figuronin në PVF si padi aktive;
- një një rast, në vlerë prej 333,333€, ishte prezantuar si detyrim kontingjent, ndonëse Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit kishte shpallur mungesë juridiksioni për shqyrtimin e rastit dhe pala ishte udhëzuar që çështjen ta ndjekë në gjykatë. Paditësi nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim të mëtejshëm gjyqësor;
- në 15 raste, në vlerë prej 894,335€, procedurat kishin përfunduar në përmbartim, megjithatë ato ende figuronin në PVF si detyrime kontingjent; dhe
- në tetë raste, në vlerë prej 232,866€, lëndët ishin paraqitur dy herë si detyrime kontingjente, duke shkaktuar dyfishim të vlerës së tyre.

Këto gabime kishin ndikuar që detyrimet kontingjente të mos paraqiten në mënyrë të drejtë dhe të saktë në PVF.

Kjo situatë kishte ndodhur si rezultat i mungesës së një sistemi efektiv për

menaxhimin dhe përditësimin e lëndëve gjyqësore, të cilat mbaheshin në formë fizike, si dhe mungesës së koordinimit dhe kontrolleve të mjaftueshme ndërmjet zyrës ligjore dhe asaj financiare për verifikimin dhe raportimin e saktë të detyrimeve kontingjente. Po ashtu, nuk ishin kryer rishikime dhe harmonizime të rregullta të lëndëve para përgatitjes së PVF-ve. Kjo çështje është përsëritur ndër vite, mirëpo gjatë vitit 2025 vlera e gabimeve të identifikuar ishte dukshëm më e lartë.

Ndikimi

Prezantimi jo i saktë i detyrimeve kontingjente ndikon në pasqyrim jo të drejtë të gjendjes financiare në PVF dhe pamundëson informimin e drejtë të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare lidhur me ekspozimin real të komunës ndaj detyrimeve potenciale. Po ashtu, kjo ndikon edhe në planifikim jo adekuat të buxhetit për vitet vijuese.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme për menaxhimin dhe përditësimin e detyrimeve kontingjente, përfshirë krijimin dhe mirëmbajtjen e një regjistri të plotë dhe të përditësuar për lëndët gjyqësore dhe paditë në proces. Gjithashtu, zyra ligjore dhe ajo financiare duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme për verifikimin, vlerësimin dhe raportimin e saktë të detyrimeve kontingjente në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Vonesa në ekzekutimin e vendimeve për ankesat e tatimpaguesve

Gjetja Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 31, paragrafi 6 përcakton se Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar.

Komuna po përballet me numër të madh të ankesave nga tatimpaguesit, si rezultat i gabimeve në faturat e tatimit në pronë dhe mungesës së trajtimit dhe ekzekutimit me kohë të vendimeve të miratuara. Sipas evidencave të pranuar, numri i vendimeve të paekzekutuara për vitin 2025 ishte 1,208 raste. Po ashtu, deri në muajin prill 2026 ishin miratuar edhe 370 vendime të tjera, të cilat ende nuk ishin ekzekutuar, duke treguar vazhdimësinë e problemit edhe gjatë vitit 2026.

Në dy raste kemi identifikuar parregullsi konkrete si në vijim:

- në rastin e parë, tatimpaguesi ishte ngarkuar me detyrim tatimor për pronën e shitur gjatë vitit 2024, përkundër faktit se obligimi tatimor është dashur të bartet te poseduesi aktual i pronës. Si pasojë e borxhit të evidentuar gabimisht, tatimpaguesit i ishte bllokuar llogaria bankare. Për këtë rast ishte ushtruar ankesë dhe vendimi në favor të tatimpaguesit ishte marrë në muajin mars 2025, mirëpo ende nuk ishte ekzekutuar;

- në rastin e dytë, tatimpaguesi ishte ankuar lidhur me mosevidentimin e parapagimit dhe mosbartjen e pronave të pronarët sipas dokumentacionit përkatës. Për këtë rast ishte marrë vendim në muajin korrik 2025, mirëpo ai ende nuk ishte zbatuar.

Mos ekzekutimi me kohë i vendimeve kishte ndodhur për shkak se departamenti i Tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, kompetente për menaxhimin e sistemit të tatimit në pronë, pas krijimit të sistemit të ri të tatimit në pronë nuk kishte lëshuar qasje për zyrtarët komunalë përgjegjës për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Ndikimi Mos ekzekutimi me kohë i vendimeve ka shkaktuar evidentim jo të saktë të detyrimeve tatimore, rritje të numrit të ankesave dhe bllokim të padrejtë të llogarive të tatimpaguesve. Po ashtu, kjo ka ndikuar negativisht në efikasitetin e administrimit të tatimit në pronë dhe në besimin e qytetarëve ndaj komunës.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e masave për ekzekutimin me kohë të vendimeve lidhur me ankesat e tatimpaguesve, azhurnimin e saktë dhe me kohë të të dhënave pronësore dhe financiare në sistem, si dhe në bashkëpunim me DTP-MF të sigurojë qasje për zyrtarët komunalë përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme për të parandaluar ngarkesat e pasakta dhe përsëritjen e rasteve të ngjashme në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Gabime në llogaritjen e tarifave për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës**Gjetja**

Sipas Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, neni 7, pika 7.1, për njësitë e reja të banimit tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për ndërtimet e kategorisë I - shtëpi individuale të banimit me hapësirë deri në 450m² është 4.30€/m², ndërsa për ndërtimet e kategorisë II është 10.70€/m².

Po ashtu, pika 7.3 përcakton koeficientin “k” për sipërfaqe të ndryshme të banesës, si në vijim: ballkonet k=0.5, loxhat k=0.75, tarracat e mbuluara k=0.5, tarracat e pambuluara k=0.25 dhe depot brenda banesës k=0.5.

Në tri raste kemi identifikuar gabime në llogaritjen e tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës. Në dy raste komuna ishte dëmtuar për 2,759€, ndërsa në një rast pala ishte dëmtuar për 962€ nëse tarracat ishin të pambuluara apo për 481€ nëse tarracat ishin të mbuluara. Rastet e identifikuar janë si në vijim:

1. sipas Aktvendimit 05 Nr. 351/02-5003/25, datë 03.04.2025, për shtëpi individuale të banimit me hapësirë 661.43m², tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës ishte llogaritur me 4.30€/m² në vend të 10.70€/m², duke dëmtuar komunën për 2,139€
2. sipas Aktvendimit 05 Nr. 351/02-157935/23, datë 19.04.2024, për ndërtesën B4, tek niveli ndërtimor PH, koeficienti për ballkon ishte llogaritur 0.25 në vend të 0.5, duke dëmtuar komunën për 620€; dhe
3. sipas Aktvendimit 05 Nr. 351/02-11916/24, datë 19.03.2025, në llogaritjen e tarifës ishte përdorur përskrimi “tarracë” pa u përcaktuar nëse bëhej fjalë për tarracë të mbuluar apo të pambuluar. Për më tepër, ishte aplikuar koeficienti i loxhes k=0.75, në vend të k=0.5 për tarracë të mbuluar ose k=0.25 për tarracë të pambuluar. Si rezultat, pala ishte dëmtuar për 962€ nëse tarracat ishin të pambuluara apo për 481€ nëse tarracat ishin të mbuluara.

Aplikimi jo i saktë i tarifave dhe koeficientëve kishte ndodhur si rezultat i dobësive në kontrollin e brendshme dhe mungesës së verifikimit të mjaftueshëm gjatë procesit të llogaritjes dhe miratimit të tarifave.

Ndikimi

Gabimet në llogaritjen e tarifave për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës kanë ndikuar në humbjen e të hyrave komunale dhe në kalkulim jo të drejtë të obligimeve ndaj palëve, duke krijuar trajtim jo të barabartë dhe duke ndikuar në besueshmërinë e procesit të llogaritjes dhe arkëtimit të tarifave komunale.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë kontroll dhe verifikim të detajuar të llogaritjeve për leje ndërtimore, duke aplikuar në mënyrë të saktë koeficientet dhe tarifën e përcaktuar me rregulloret në fuqi. Po ashtu, duhet të forcohen mekanizmat e kontrollit dhe rishikimit të llogaritjeve para miratimit të tyre, me qëllim të parandalimit të gabimeve dhe sigurimit të trajtimit të drejtë të palëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Dobësi në menaxhimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e pronës komunale në kuadër të projektit “Modernizimi i arsimit përmes inovacionit dhe trashëgimisë”**Gjetja**

Me datën 05.09.2024, Komuna kishte lidhur marrëveshje financiare me UNDP-në për realizimin e projektit “Modernizimi i arsimit përmes inovacionit dhe trashëgimisë”, përmes së cilës zbatimi dhe menaxhimi i aktiviteteve i ishte deleguar UNDP-së. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Komuna kishte transferuar mjete në formë parapagimi në vlerë prej 5,120,000€.

Sipas nenit 7 të Marrëveshjes financiare në mes Komunës dhe UNDP-së për projektin “Modernizimi i Arsimit Përmes Inovacionit dhe Trashëgimisë”, UNDP-ja duhet t’i sigurojë Komunës, sipas kërkesës, raporte financiare dhe raporte të tjera të përgatitura në përputhje me procedurat e raportimit të UNDP-së.

Ndërsa, sipas nenit 8 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, prona e paluajtshme komunale mund të jepet në shfrytëzim vetëm pas aprovimit nga Kuvendi Komunal dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara ligjore.

Kjo marrëveshje, ishte në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjin e Buxhetit për vitin 2024 për shkak se Komuna kishte deleguar të gjitha përgjegjësitë për zhvillimin e procedurave të prokurimit tek UNDP, por edhe kishte transferuar në formë të parapagimit të gjitha fondet tek UNDP.

Gjithashtu, ndryshimet në fushëveprimin e projektit, rialokimi i aktiviteteve duhet të jenë të dokumentuara, të arsyetuara dhe të mbështetura me analiza përkatëse, në mënyrë që të sigurohet realizimi i objektivave dhe rezultateve të parapara me projekt dokumentin.

Bazuar në projekt dokument, për realizimin e projektit janë paraparë katër outpute që lidhen me rehabilitimin dhe rindërtimin e ndërtesës së Gërmisë, rehabilitimin dhe rizhvillimin e ndërtesës së Tulltorës, reformën në mësim përmes të nxënit virtual, si dhe forcimin e kapaciteteve komunale për zbatimin e ndryshimeve strukturore afatshkurtra dhe afatgjata. Data e përfundimit të projektit ishte përcaktuar 31.08.2026.

Gjatë auditimit kemi vërejtur çështjet si në vijim:

a) Komuna nuk kishte kërkuar dhe siguruar me kohë raporte financiare dhe raporte monitorimi lidhur me ecurinë dhe realizimin e projektit, përkundër vlerës së konsiderueshme të mjeteve të transferuara dhe mundësisë së përcaktuar në marrëveshje që UNDP-ja t’i ofrojë këto raporte me kërkesë të Komunës. Raportet nga UNDP-ja ishin siguruar vetëm gjatë vitit 2026 pas kërkesës së auditorit. Nga koordinatori e Komunës ishte siguruar vetëm një raport i kompletimit të punëve për renovimin e pjesërishëm të objektit Gërmia.

b) Për shkak të realizimit të parapagimit ndaj UNDP-së, auditorët nuk kishin qasje të drejtpërdrejtë në dokumentacionin dhe shpenzimet e realizuara nga UNDP-ja për zbatimin e projektit, çka kufizoi mundësinë e verifikimit të plotë të shfrytëzimit të mjeteve dhe realizimit të aktiviteteve të projektit. Si rezultat, auditimi është mbështetur kryesisht në raportet dhe informacionet

e siguruara nga koordinatorja e projektit.

c) Sipas raportit të UNDP-së, projekti kishte pësuar ndryshime në fushëveprim, aktivitete dhe rialokim të buxhetit, pasi kostot e rehabilitimit dhe funksionalizimit të kompleksit të Tulltorës kishin tejkaluar buxhetin në dispozicion. Fillimisht, projekti kishte paraparë rivitalizimin e plotë të ndërtesave D1, D2 dhe D3 për instalimin e sistemit “Deep Space 8K” dhe mini-fabrikës robotike për prodhim të tullave, me vlerë të vlerësuar të investimit prej rreth 7,000,000€, ndërsa buxheti total i projektit METIAH ishte rreth 5,000,000€. Pas konsultimeve ndërmjet Komunës dhe UNDP-së gjatë vitit 2025, fushëveprimi i projektit ishte reduktuar në disa faza, duke kufizuar ndërhyrjet vetëm në ndërtesën D1 dhe duke zhvendosur sistemin “Deep Space 8K” nga Tulltorja në ish-objektin e Gërmisë. Sipas raportit të UNDP-së, instalimi i linjës robotike të prodhimit mund të fillojë vetëm pas finalizimit të shumicës së punimeve ndërtimore dhe në varësi të konfirmimit të financimit dhe aprovimeve përfundimtare. Përkundër këtyre ndryshimeve, Komuna nuk kishte siguruar analiza apo dokumentacion të mjaftueshëm lidhur me ndikimin e tyre në arritjen e objektivave të projektit dhe nuk ishte evidentuar ndonjë aprovim formal për ndryshimin e fushëveprimit.

d) Në ish-objektin e Gërmisë ishte realizuar renovim i pjesërishtëm dhe ishte instaluar sistemi “Deep Space 8K”. Gjatë verifikimit fizik të realizuar më 08.05.2026 kemi vërejtur se kjo hapësirë menaxhohej nga UNDP dhe ishte dhënë në shfrytëzim një operatori privat, i cili inkasonte të hyra nga menaxhimi i hapësirës. Komuna nuk kishte mekanizma monitorimi dhe kontrolli lidhur me të hyrat e realizuara, si dhe nuk ishte përcaktuar ndonjë përfitim financiar për Komunën.

e) Sipas konfirmimit të Drejtorisë së Pronës, për këtë pronë nuk ishin zhvilluar procedura për dhënie në shfrytëzim dhe nuk kishte aprovim paraprak nga Kuvendi Komunal. Po ashtu, nga konfirmimet me personat e angazhuar në menaxhim është konfirmuar se operatori privat nuk kishte obligime financiare apo kontraktuale ndaj Komunës, por vetëm marrëdhënie me UNDP-në. Përkundër faktit se objekti është pronë komunale, nuk ishte evidentuar ndonjë vendim i Kuvendit Komunal apo procedurë ligjore për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone.

Monitorimi dhe koordinimi ndërmjet Komunës dhe UNDP-së lidhur me zbatimin e projektit janë zhvilluar kryesisht përmes komunikimeve dhe takimeve koordinuese, mirëpo mungesa e dokumentimit me shkrim, analizave dhe raporteve të rregullta financiare dhe operative ka ndikuar që Komuna të mos ketë evidencë të plotë dhe të dokumentuar lidhur me progresin, ndryshimet në fushëveprim, rialokimin e aktiviteteve dhe buxhetit gjatë zbatimit të projektit. Po ashtu, moszbatimi i kërkesave ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale ka rezultuar me përdorimin e objektit pa aprovim nga Kuvendi Komunal dhe pa procedura të përcaktuara ligjore.

Ndikimi

Mungesa e dokumentimit të rregullt të komunikimeve, analizave dhe raporteve financiare dhe operative ka kufizuar mundësinë e Komunës dhe auditorëve për të verifikuar në mënyrë të plotë progresin e projektit, shfrytëzimin e mjeteve të transferuara dhe realizimin e aktiviteteve të parapara. Po ashtu, ndryshimet në fushëveprim, rialokimi i aktiviteteve dhe buxhetit pa dokumentim dhe analiza të mjaftueshme rrisin rrezikun që objektivat fillestare të projektit, veçanërisht revitalizimi i kompleksit të Tulltorës dhe funksionalizimi i linjës së prodhimit robotik, të mos realizohen

sipas planifikimit fillestar. Gjithashtu, dhënia në shfrytëzim e pronës komunale pa aprovim dhe pa mekanizma monitorimi rrit rrezikun e menaxhimit joefektiv të pronës publike dhe pamundëson vlerësimin e përfitimeve financiare për Komunën.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që komunikimet, vendimmarrja dhe koordinimi me UNDP-në lidhur me zbatimin e projektit të dokumentohen në mënyrë të rregullt dhe të mbështeten me analiza, raporte financiare dhe operative për progresin dhe realizimin e aktiviteteve të projektit. Gjithashtu, duhet të sigurohet që ndryshimet në fushëveprim, aktivitetet dhe rialokimi i buxhetit të jenë të dokumentuara, të arsyetuara dhe të aprovuara në mënyrë formale, duke vlerësuar ndikimin e tyre në arritjen e objektivave të projektit. Po ashtu, përdorimi dhe dhënia në shfrytëzim e pronës komunale duhet të realizohet vetëm pas aprovimeve dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, duke siguruar edhe mekanizma monitorimi dhe përfitime të qarta për Komunën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Zbatim i kontratës nga operatorë ekonomik të paautorizuar

Gjetja

Sipas nenit 30 të Ligjit të Prokurimit Publik në lidhje me nën-kontraktimin; Tenderuesi duhet të tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës që ai ka për qëllim të nënkontrakttojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Gjithashtu, sipas pikës 4.2 të kontratës në mes të Komunës dhe OE, elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve duhet të bëhen të ditura në momentin e dorëzimit të ofertës, ndërsa çdo nënkontraktim gjatë zbatimit të kontratës kërkon njoftim me shkrim dhe miratim nga Autoriteti Kontraktues, i cili duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve pune. Po ashtu, nënkontraktuesit duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

Nga dy pagesa në vlerë totale prej 261,269€ kemi vërejtur se në kontratën "Ofrimi i shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave - Lot 2", një pjesë e shërbimeve ishte realizuar nga një operator ekonomik që nuk ishte pjesë e grupit ekonomik me të cilin ishte nënshkruar kontrata.

Kjo ishte evidentuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës të pagesave, përkatësisht faturave të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A. (KMDK), ku paraqiteshin sasisht e mbeturinave të deponuara dhe operatorët ekonomik që kishin bërë dorëzimin e tyre në deponi. Nga këto fatura kemi vërejtur se një pjesë e mbeturinave ishte grumbulluar dhe deponuar nga operator ekonomik që nuk figuronte në kontratën e lidhur me komunën. Si rezultat, një pjesë e shërbimeve ishte realizuar nga operator ekonomik i paautorizuar nga Autoriteti Kontraktues. Për këtë operator ekonomik nuk kishte marrëveshje të nënkontraktimit dhe as njoftim paraprak ndaj Autoritetit Kontraktues për angazhimin e tij.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrollit dhe monitorimit adekuat nga menaxheri i kontratës gjatë zbatimit të saj.

Ndikimi

Angazhimi i operatorëve ekonomikë që nuk janë pjesë e kontratës dhe që nuk janë aprovuar përmes procedurave të parapara të nënkontraktimit rrit rrezikun e mosrespektimit të kushteve kontraktuale dhe kërkesave të

legjislacionit për prokurimin publik. Po ashtu, mungesa e kontrollit adekuat gjatë zbatimit të kontratës ndikon në uljen e llogaridhënies dhe vështirëson monitorimin e cilësisë dhe përgjegjësi për shërbimet e ofruara, si dhe krijon rrezik që operatorët ekonomikë të angazhohen pa kaluar vlerësimin dhe kriteret e parapara në procedurën e prokurimit.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e kontratave publike, duke verifikuar që shërbimet të ofrohen vetëm nga operatorët ekonomik të kontraktuar ose nga nënkontraktorët e aprovuar paraprakisht, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik. Po ashtu, çdo angazhim i nënkontraktorëve duhet të aprovohet dhe dokumentohet sipas procedurave të parapara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Aplikim i gabuar i peshimit të çmimeve dhe i pragut $\pm 30\%$ në kontratë

Gjetja

Neni 31 i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik përcakton se, kurdo që Autoriteti Kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve/artikujve” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë për qind (30%)

Në dy raste, për kontratat e nënshkuara në vitin 2025 për “Ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave - Lot 1 dhe Lot 2”, Komuna kishte aplikuar kontratë publike kornizë me çmime për njësi. Për shkak të sasive indikative, vlerësimi i ofertave ishte bërë përmes peshimit të çmimeve, përkatësisht çmimeve të poentuara sipas peshës së secilit pozicion.

Megjithatë, në nenin 3 të kontratave janë përfshirë njëkohësisht vlerat totale indikative të kontratave prej 1,200,000€ për Lot 1 dhe 800,000€ për Lot 2, çmimet e peshuara prej 65.80€ për Lot 1 dhe 65.50€ për Lot 2, si dhe devijimi i lejuar prej $\pm 30\%$.

Përfshirja e pragut $\pm 30\%$ në këto kontrata nuk ishte në përputhje me kërkesat e rregullores, pasi në kontratat me çmime për njësi, ku vlerësimi bëhet përmes çmimeve të poentuara, nuk lejohet aplikimi i këtij pragu.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e interpretimit dhe aplikimit jo të duhur të kërkesave të rregullores për kontratat publike kornizë me çmime për njësi dhe mungesës së kontrolleve të mjaftueshme gjatë hartimit dhe nënshkrimit të kontratave.

Ndikimi

Përfshirja e elementeve të papajtueshme në kontratë rrit rrezikun për zbatim jo të drejtë të saj dhe krijon paqartësi në menaxhimin e kontratës. Po ashtu, përdorimi i pragut $\pm 30\%$ në kundërshtim me rregulloren cenon parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik.

Rekomandimi A6

Komuna duhet të sigurojë që në kontratat me çmime për njësi, ku aplikohet

peshimi i çmimeve të poentuara, të mos përfshihet pragu +/-30%, në përputhje me kërkesat e rregullores. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet gjatë hartimit dhe rishikimit të kontratave për të siguruar që elementet e përfshira janë të qarta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme

Gjetja

Neni 12, paragrafi 7 i Ligji nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2025, limitet në zotime dhe shpenzime, Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në raste se shpenzime e tilla për kosto totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025 dhe për dy (2) vitet në vijim. Ndërkaq, tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale, tregon planifikimin e financimit të projekteve dhe shumat e ndara që duhet të realizohen brenda tri viteve.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se Komuna në tri raste kishte lidhur kontrata pa pasur fonde të mjaftueshme të parapara në Ligjin e Buxhetit:

- Për projektin “Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush” me vlerë 18,162,896€, me afat të përfundimit të punimeve prej 240 ditë pune, sipas Ligjit të Buxhetit Komuna kishte të ndara mjete buxhetore për periudhën 2025-2027 në vlerë totale prej 1,550,000€, që nënkupton se kishte hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë të mjaftueshme buxhetore. Komuna kishte paraparë mjete në vlerë prej 4,500,000€ në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, mirëpo ato nuk ishin përfshirë në Ligjin e Buxhetit 2025 për shkak të mosaprovimit me kohë të buxhetit për vitin 2025.

- Për projektin “Ndërtimi i krahut të rrugës Muharrem Fejza - Rruga Prekazi” me vlerë të kontraktuar prej 394,772€, Komuna nuk kishte mjete të ndara në Ligjin e Buxhetit. Komuna kishte paraparë mjete prej 1,500,000€ në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, mirëpo ato nuk ishin përfshirë në Ligjin e Buxhetit 2025 për shkak të mosaprovimit me kohë të buxhetit për vitin 2025.

- Për projektin “Furnizim me automjete për nevojat e QKMF-së dhe QMU” me vlerë prej 176,855€, sipas Ligjit të Buxhetit Komuna kishte të ndara mjete për vitin 2025 në vlerë prej 50,000€, ndërsa për periudhën 2025-2027 në vlerë totale prej 168,580€. Duke qenë se afati për dorëzim kishte qenë 90 ditë nga dhënia e urdhërblerjes nga Autoriteti Kontraktues, Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale përtej mbulesës së planifikuar buxhetore sipas Ligjit të Buxhetit.

Si rezultat, Komuna kishte marrë obligime kontraktuale pa siguruar paraprakisht mbulesë të mjaftueshme buxhetore sipas kërkesave të Ligjit të Buxhetit.

Kjo kishte ndodhur për shkak se buxheti i Komunës për vitin 2025 ishte aprovuar me vonesë nga Kuvendi Komunal dhe, si rezultat, projektet e planifikuara në Kornizën Afatmesme Buxhetore nuk ishin përfshirë në Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025. Pavarësisht kësaj, Komuna kishte vazhduar me iniciimin dhe nënshkrimin e kontratave pa siguruar paraprakisht mbulesë të mjaftueshme buxhetore të aprovuar.

- Ndikimi** Hyrja në obligime kontraktuale pa mbulesë të mjaftueshme buxhetore rrit rrezikun e vështirësive në financimin e projekteve, vonesave në realizimin e tyre, si dhe krijimit të obligimeve të papaguara ndaj operatorëve ekonomik.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë që para inicimit dhe nënshkrimit të kontratave shumëvjeçare të ekzistojë mbulesë e mjaftueshme buxhetore e aprovuar në Ligjin e Buxhetit për tërë periudhën e realizimit të projekteve, në mënyrë që të shmanget hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të sigurta financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Fillimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratave pa sigurimin paraprak të lejeve ndërtimore

Gjetja Sipas neni 5 paragrafi 1.1 i Ligjit të ndërtimit, thekson se llojet e ndërtimit janë ndërtimi i ri (përfshirë edhe instalimin), rindërtimi, riparimi - renovimi, sanimi, rehabilitimi-përmirësimi (nuk kërkon leje ndërtimi), punët ndërtimore që kanë për synim mbrojtjen e monumenteve të palëvizshme të trashëgimisë kulturore, rrënimi, ndërtime peizazhi dhe instalimi apo ngritja e ndërtimeve të përkohshme.

Neni 19 i këtij ligji thekson se Komunitat lëshojnë leje ndërtimore për kategoritë I dhe II të ndërtimeve. Ndërsa, neni 21 për procedurën e lëshimit të lejes ndërtimore thekson se leja ndërtimore lëshohet nëse dokumentacioni ndërtimor përgatitet në pajtueshmëri me kushtet ndërtimore dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Kodit si dhe Ligjit mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe zonat e veçanta të mbrojtura.

Gjithashtu, sipas nenit Nr. 19.14 001/2022 të Rregullores për prokurim publik përcaktohet se specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performances të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutues. Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përgatitet në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin specifik që është në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe, në raste kur kërkohet, rregullave të përcaktuara në çertifikatat administrative dhe lejet e nevojshme për punimet që do të ekzekutohen.

Gjatë auditimit janë evidentuar dy raste ku procedurat e prokurimit dhe nënshkrimi i kontratave janë zhvilluar para sigurimit të lejeve dhe pëlqimeve të nevojshme për realizimin e punimeve. Rastet e identifikuar janë:

- Në projektin “Ndërtimi i Sheshit Xhorxh Bush”, me vlerë të kontratës prej 18,162,896€, kontrata për realizimin e projektit ishte nënshkruar më 06.02.2025, ndërsa pëlqimi nga Drejtoria e Urbanizmit për lejimin e zhvillimit të punimeve ndërtimore ishte lëshuar më 10.03.2025. Ky pëlqim kishte lejuar zhvillimin e punimeve në të gjithë hapësirën, përveç punimeve strukturore në Sheshin Qendror, të cilat do të mund të realizoheshin vetëm pas sigurimit të marrëveshjeve për parcelat me posedim individual, pëlqimit nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve përmes QRK-së, pëlqimeve për mbrojtje nga zjarri, lejes mjedisore komunale, si dhe pëlqimeve nga institucionet relevante si KEDS, KUR, Telekom dhe Termokos. Përkundër kësaj, procedura e prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës ishin zhvilluar para sigurimit të lejes ndërtimore dhe pa u plotësuar të gjitha kushtet administrative dhe ligjore për realizimin e

punimeve. Si rezultat, punimet në hapësirat e zonës mbrojtëse ishin pezulluar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, ndërsa Komuna kishte vazhduar realizimin e punimeve vetëm në pjesët jashtë perimetrit të pezulluar; dhe

- Në projektin “Ndërtimi i Tregjeve të Gjelbra”, me vlerë të kontratës prej 1,014,736€, kontrata ishte nënshkruar më 23.05.2025, ndërsa kërkesa në Drejtorinë e Urbanizmit për pajisje me leje ishte dorëzuar më 11.06.2025. Po ashtu, pëlqimi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për kryerjen e punimeve ishte lëshuar më 29.07.2025, përkatësisht pas nënshkrimit të kontratës. Sipas konfirmimeve të pranuar nga Drejtoria e Urbanizmit, kërkesa për pajisje me leje ende ishte në procedurë të shqyrtimit. Për më tepër, punimet në këtë projekt ishin pezulluar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, i cili kishte kërkuar plotësim-ndryshime të projektit. Sipas dokumentacionit, projekti i plotësuar nga Komuna ishte dorëzuar më 29.04.2026, ndërsa punimet nuk mund të vazhdonin deri në marrjen e pëlqimeve dhe autorizimeve përkatëse. Si rezultat, procedura e prokurimit dhe hyrja në obligime kontraktuale ishin zhvilluar para sigurimit të dokumentacionit dhe pëlqimeve të nevojshme për realizimin e punimeve, duke mos respektuar kërkesat ligjore dhe administrative.

Këto situata kanë ndodhur si rezultat i mangësive në planifikimin e projekteve dhe mungesës së mekanizmave efektiv të kontrollit të brendshëm, për të siguruar se dokumentacioni i nevojshëm është përgatitur dhe verifikuar përpara nisjes së procedurave të prokurimit dhe lidhjes së kontratave.

Ndikimi

Zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe hyrja në obligime kontraktuale pa sigurimin paraprak të lejeve dhe pëlqimeve të nevojshme ka ndikuar në pezullimi e punimeve, rrezikon vonesa në realizimin e projekteve, ndryshimeve shtesë në projekte, kostove shtesë financiare dhe realizimit të projekteve në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe administrative në fuqi.

Rekomandimi B5

Komuna duhet të sigurojë që asnjë procedurë prokurimi për projekte ndërtimi të mos fillojë pa u pajisur më parë me lejen ndërtimore, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Ndërtim. Po ashtu, duhet të forcohen mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të vendosen kërkesa të qarta të bashkëpunimit ndërmjet drejtorive përkatëse në mënyrë që lejet për fillimin e punimeve të jepen para inicimit të procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe vonesa në ekzekutimin e pagesave**Gjetja**

Sipas nenit 39 të LMFPP-së, përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.

Ndërsa sipas nenit 40 të LMFPP, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrat të prerë nga gjykata/ përmbarusi.

Gjatë vitit 2025, vlera e pagesave të realizuara përmes vendimeve gjyqësore ishte shumë e lartë, duke arritur në 45,691,077€.

Gjatë testimit të pagesave të realizuara përmes vendimeve gjyqësore kemi identifikuar mangësi në klasifikimin, dokumentimin dhe verifikimin e tyre, si dhe vonesa në realizimin e pagesave përtej afatit ligjor prej 30 ditësh.

a) Nga testimi i pagesave të realizuara përmes vendimeve gjyqësore kemi identifikuar mangësi në klasifikimin, dokumentimin dhe verifikimin e tyre. Pagesat ishin realizuar nga kategori të ndryshme ekonomike, ndërsa në disa raste mungesa e urdhrave përmbarimorë nuk na ka mundësuar ndarjen e saktë ndërmjet vlerës bazë, kamatës dhe shpenzimeve përmbarimore.

Rastet e identifikuara janë si më poshtë:

- Nga kategoria e investimeve kapitale ishin realizuar nëntë pagesa në vlerë prej 4,496,994€, ndërsa shpenzimet e kamatës dhe përmbarimit për këto pagesa ishin 81,800€.

- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin testuar 16 pagesa në vlerë prej 3,963,155€. Për pesë prej këtyre pagesave, në vlerë prej 1,722,821€, janë siguruar dëshmi për shpenzimet e përmbarimit në vlerë prej 226,851€. Ndërsa, për 11 pagesa në vlerë prej 2,190,334€, nuk janë siguruar urdhrat përmbarimorë, andaj nuk kemi mundur të përcaktojmë ndarjen ndërmjet vlerës bazë, kamatës dhe shpenzimeve përmbarimore.

- Po ashtu, për një pagesë të realizuar nga kategoria e subvencioneve për paga dhe mëditje, në vlerë prej 134,445€, nuk janë siguruar urdhrat përmbarimorë, me qëllim të verifikimit dhe ndarjes së shpenzimeve.

- Në një rast tjetër, tek një vendim gjyqësor i paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 147,143€ për paga jubilarë, kemi vërejtur se shuma prej 11,758€ kishte të bënte me dy punonjës për të cilët debitor nuk ishte Komuna e Prishtinës, por Ministria e Punëve të Brendshme. Megjithatë, pagesa ishte realizuar nga Komuna, pasi këta punonjës ishin përfshirë në listën e pagesës.

b) Gjithashtu, nga testimi i 22 pagesave tek investimet kapitale, në vlerë të përgjithshme prej 5,367,739€, si dhe 20 pagesave tek mallrat dhe shërbimet, në vlerë totale prej 2,797,791€, kemi vërejtur se faturat ishin paguar me vonesë, përtej afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat në pagesë kanë qenë nga 9 deri në 131 ditë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve të mjaftueshme financiare dhe numrit të madh të obligimeve të bartura ndër vite, të cilat

janë ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore dhe procedurave përmbartimore. Gjatë vitit 2025, vlera e pagesave të realizuara përmes vendimeve gjyqësore ishte shumë e lartë, duke arritur në 45,691,077€, gjë që ka ndikuar në vështirësi në menaxhimin, verifikimin dhe ekzekutimin me kohë të obligimeve.

Ndikimi Kjo kishte ndodhur për shkak të kufizimeve buxhetore, vonesës në miratimin e buxhetit për vitin 2025 dhe obligimeve të shumta të bartura nga vitet paraprake, të cilat kanë ndikuar në pamundësinë e ekzekutimit me kohë të obligimeve financiare. Si rezultat, faturat janë vonuar për pagesë përtej afateve ligjore, ndërsa është rritur edhe numri i pagesave të realizuara përmes vendimeve gjyqësore dhe procedurave përmbartimore.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë planifikim dhe menaxhim më efektiv të mjeteve buxhetore, me qëllim të ekzekutimit me kohë të obligimeve financiare dhe shmangies së pagesave shtesë nga kamatat, shpenzimet përmbartimore dhe vendimet gjyqësore. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet në dokumentimin, verifikimin dhe klasifikimin e pagesave të realizuara përmes procedurave gjyqësore dhe përmbartimore

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Ndryshimet buxhetore për projekte kapitale pa aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal

Gjetja Sipas nenit 16 paragrafi 11, të ligjit të buxhetit nr 08/L-332 për vitin 2025 ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2. duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se për 46 pagesa të investimeve kapitale, në vlerë totale prej 10,192,709€, fondet janë marrë nga projekte të tjera të aprovuara me Ligjin e Buxhetit. Në 43 raste, në vlerë prej 9,979,842€, pagesat janë realizuar bazuar në kërkesat e drejtorëve të drejtorive përkatëse dhe me aprovim të Kryetarit, ndërsa në tri raste, në vlerë prej 212,867€, pagesat janë realizuar pa urdhëresë përkatëse.

Si raste ku janë vërejtur më shumë mjete të marra nga projekte të tjera kapitale janë: pagesa e faturës në vlerë prej 500,000€ për projektin “Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush”, ku fondet janë marrë nga 15 projekte të ndryshme kapitale, si dhe pagesa në vlerë prej 173,365€ për projektin “Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria”, ku mjetet janë marrë nga 8 projekte të ndryshme.

Këto raste paraqesin ndryshime të konsiderueshme në shpërndarjen e mjeteve buxhetore ndërmjet projekteve kapitale, pa aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal, siç kërkohet me ligj.

Kjo çështje është përsëritur ndër vite, ndërsa gjatë vitit 2025 është vërejtur rritje e konsiderueshme e rasteve të ndryshimeve buxhetore ndërmjet projekteve kapitale. Kjo ka ndodhur si rezultat i hyrjes në obligime kontraktuale pa mbulueshmëri të mjaftueshme financiare dhe mosreflektimit të nevojave reale të projekteve kapitale në buxhet, aprovimit me vonesë të buxhetit për vitin 2025, realizimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore nga kategori të tjera ekonomike, si dhe rasteve të keqklasifikimit të

pagesave për shpenzime operative, si transporti dhe energjia elektrike, të realizuara nga kategori jo adekuate.

Ndikimi Ndryshimet buxhetore ndërmjet projekteve kapitale pa aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal kanë ndikuar në mosrespektimin e kërkesave ligjore dhe kanë dobësuar kontrollin mbi shpenzimin e buxhetit. Po ashtu, marrja e mjeteve nga projekte të tjera ndikon në vonesa në realizimin e tyre, krijimin e vështirësisë në planifikimin dhe realizimin e buxhetit, si dhe të rrisë rrezikun që projektet nga të cilat janë marrë mjetet të mos realizohen sipas planifikimit.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë që ndryshimet buxhetore ndërmjet projekteve kapitale të bëhen vetëm pas aprovimit paraprak nga Kuvendi Komunal, në përputhje me kërkesat ligjore. Po ashtu, duhet të përmirësohet planifikimi buxhetor dhe monitorimi i obligimeve kontraktuale për të shmangur përdorimin e mjeteve nga projekte të tjera kapitale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Në kontratat e nënshkruara ndërmjet Komunës dhe operatorëve ekonomik përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve, ndërsa autoriteti kontraktues duhet të sigurojë menaxhim dhe monitorim efektiv të kontratave për realizimin e projekteve brenda afateve të përcaktuara.

Në gjashtë kontrata për investime kapitale, punimet nuk ishin realizuar brenda afateve të përcaktuara me kontratë dhe plan dinamik. Në disa raste, edhe pse ishin lidhur amandamente apo aneks-kontrata për zgjatje të afateve dhe realizim të punëve shtesë, projektet ende nuk kishin përfunduar në kohën e auditimit (maj 2026), ndërsa afatet e realizimit vazhdonin të shtyheshin.

- Kontrata “Ndërtimi i ishullit urban Arbëri - Pallati i Rinisë”, në vlerë prej 6,589,459.60€, e nënshkruar më 23.10.2024, me afat përfundimi 180 ditë nga data 30.10.2024. Projekti ende nuk kishte përfunduar në kohën e auditimit (maj 2026);

- Kontrata “Ndërtimi i rrugës A - pjesa e parë”, në vlerë prej 8,497,801€, e nënshkruar më 24.04.2023, me afat përfundimi 240 ditë, duke filluar 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Më 27.09.2024 ishte bërë amandament për zgjatje të afatit edhe për 90 ditë pune. Për këtë kontratë ishin lidhur edhe dy aneks-kontrata në vlerë prej 170,000€ dhe 659,000€, me afate përfundimi prej 30 dhe 60 ditësh. Megjithatë, projekti ende nuk kishte përfunduar në kohën e auditimit (maj 2026);

- Kontrata “Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore”, në vlerë prej 3,298,455€, e nënshkruar më 14.03.2024, me afat përfundimi 120 ditë kalendarike. Projekti ende nuk kishte përfunduar në kohën e auditimit (maj 2026);

- Kontrata “Ndërtimi i rrugës lidhëse Sofali - Kolovicë - Abedin Dino, faza II”, në vlerë prej 2,499,971€, e nënshkruar më 02.10.2024, me afat përfundimi 240 ditë. Për këtë kontratë ishte nënshkruar edhe një aneks-kontratë në vlerë prej 249,000€, më 23.06.2025, me afat 60 ditë. Projekti ende nuk

kishte përfunduar në kohën e auditimit (maj 2026);

- Kontrata “Ndërtimi i shkollës Kalabria” me vlerë të kontraktuar prej 2,847,777€ ishte nënshkruar më 20.05.2024, ku fillimi i punëve ishte paraparë 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës, përkatësisht pas pajisjes me leje ndërtimore, ndërsa afati i realizimit ishte 300 ditë. Për këtë kontratë ishte nënshkruar edhe një aneks-kontratë në vlerë prej 100,001€ më 18.11.2024, me afat shtesë realizimi prej 90 ditësh. Deri në kohën e auditimit, punimet ende nuk kishin përfunduar. Gjatë auditimit kemi vërejtur se ende ekzistonin probleme lidhur me shtëpitë në afërsi të shkollës, të cilat sipas projektit duhej të shpronësoheshin pasi ndodhen brenda hapësirës së planifikuar të oborrit të shkollës. Për këto prona, procesi i shpronësimit ishte ende në procedurë gjyqësore.

- Kontrata “Ndërtimi i Bibliotekës në Kodër të Trimave”, në vlerë prej 418,000€, e nënshkruar më 10.12.2024 me afat përfundimi 60 ditë. Projekti ende nuk kishte përfunduar në kohën e auditimit (maj 2026).

Vonesat në realizimin e projekteve kishin ndodhur si rezultat i ndërprerjeve të punimeve nga institucionet relevante, problemeve me shpronësimet dhe pronat private, paraqitjes së nevojave për punë shtesë dhe ndryshime në pozicionet e kontratës, lidhjes së kontratave pa u pajisur paraprakisht me lejet ndërtimore, vendosjes së afateve për realizim të projekteve pa një analizë të duhur, si dhe mos përputhjes së projekteve dhe pozicioneve të kontratës me gjendjen faktike.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve kanë ndikuar në mosrealizimin e investimeve kapitale brenda afateve të planifikuara, shtyrjen e përfitimit të shërbimeve dhe infrastrukturës për qytetarët, si dhe kanë rritur rrezikun për kosto shtesë, zgjatje të kontratave, mosshfrytëzim efikas të mjeteve publike dhe vështirësi në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e projekteve.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të sigurojë që para inicimit të procedurave të prokurimit të kryhen analiza të plota dhe përgatitje adekuata të projekteve, duke përfshirë zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe harmonizimin e projekteve me gjendjen faktike në terren. Po ashtu, duhet të forcohen mekanizmat e monitorimit dhe menaxhimit të kontratave me qëllim të realizimit të projekteve brenda afateve të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B9 - Ndryshimet në kushtet e kontratës pa aprovimet e duhura

Gjetja

Sipas nenit 71.1 të Rregullores për prokurim publik nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontratë të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga menaxheri i kontratës. Në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit.

Ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet Operatorit Ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA dhe zotimit të mjeteve për kontratën e ndryshuar.

Në katër kontrata për punë kemi identifikuar ndryshime në sasi të realizuara të disa pozicioneve, përmes rritjes apo zvogëlimit të sasive të kontraktuara, ndërsa në disa raste pozicionet e kontraktuara nuk ishin

realizuar fare. Edhe pse këto ndryshime nuk kishin ndikuar në rritjen e vlerës totale të kontratës, ato ishin autorizuar vetëm nga menaxherët e kontratave, ndërkaq nuk ishte bërë amandamentimi i kontratave.

Ndryshimet janë identifikuar në kontratat si në vijim:

1. Në kontratën “Ndërtimi i tri mbikalimeve të përkohshme në Aktash, Lakrishtë dhe Arbëri”, në vlerë prej 428,216€, kishte rritje të sasive në disa pozicione në vlerë prej 11,491€, apo deri në 60% rritje krahasuar me sasi të kontraktuara. Po ashtu, nga pagesa përfundimtare kemi vërejtur se projekti kishte pësuar ndryshime të rëndësishme në krahasim me kontratën fillestare. Mbikalimi për këmbësorë nga konstruksioni metalik në lagjen Aktash, në vlerë të kontraktuar prej 103,366€, nuk ishte realizuar fare, ndërsa mbikalimi i përkohshëm “Ura the Green Corridor” nga konstruksioni i drurit, në vlerë të kontraktuar prej 30,567€, gjithashtu nuk ishte realizuar. Këto ndryshime kishin ndodhur pasi kontrata fillimisht ishte paraparë për ndërtimin e mbikalimeve të përkohshme nga materiale të lehta ndërtimore, si skele, dërrasa dhe elemente çeliku, për nevojat e Manifestës së Bienales, me qëllim të qarkullimit më të sigurt të vizitorëve gjatë manifestimit. Megjithatë, vonesat në procesin e prokurimit ndikuan që kontrata të mos realizohej brenda periudhës së manifestimit. Më pas, për shkak të kushteve teknike të vendosura për marrjen e pëlqimit nga Infracos, mbikalimi në Arbëri ishte realizuar si mbikalim i përhershëm, gjë që kishte rritur kostot dhe kishte pamundësuar financiarisht ndërtimin e mbikalimeve të tjera të përkohshme të parapara me kontratë. Si rezultat, projekti i realizuar kishte devijuar nga objekti dhe koncepti fillestar i kontratës së nënshkruar, pa u reflektuar këto ndryshime përmes procedurave formale të ndryshimit të kontratës.

2. Në kontratën “Ndërtimi i rrugëve në lagjen Kodra e Trimave”, në vlerë prej 598,764€, kishte rritje të sasive në pesë pozicione në vlerë prej 6,746€, apo deri në 80% rritje të sasive në pozicionet përkatëse. Njëkohësisht kishte edhe zvogëlim të sasive në pozicione të tjera. Kontrata ishte përmbyllur me mbetje të parealizuar prej 8,505€;

3. Në kontratën “Ndërtimi i Bibliotekës në Kodër të Trimave”, në vlerë prej 418,000€, kishte rritje të sasive në disa pozicione në vlerë prej 13,212€, apo deri në 332% rritje krahasuar me sasi të kontraktuara. Në anën tjetër, kishte edhe zvogëlim të sasive në pozicione të tjera; dhe

4. Në kontratën “Rikonstruimi i platos në lagjen Dardania, rruga Bill Clinton - tek Santea”, në vlerë prej 498,827€, kishte rritje të sasive në disa pozicione në vlerë prej 12,768€, apo deri në 235% rritje krahasuar me sasi të kontraktuara.

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit jo të duhur të nevojave dhe sasive të kontraktuara, ndryshimeve gjatë zbatimit të projekteve, si dhe mungesës së respektimit të procedurave për amandamentimin e kontratave dhe sigurimin e aprovimeve përkatëse para realizimit të ndryshimeve.

Ndikimi

Ndryshimet në sasi dhe pozicionet e kontraktuara pa amandamentim dhe aprovimet e nevojshme zvogëlojnë transparencën dhe kontrollin mbi zbatimin e kontratave. Kjo rrit rrezikun që punët e realizuara të mos jenë plotësisht në përputhje me kushtet fillestare të kontratës, të tejkalohen autorizimet e menaxherëve të kontratës, si dhe mund të ndikojë në trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe në dobësim të disiplinës

kontraktuale.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të sigurojë që çdo ndryshim në kushtet, sasitë apo pozicionet e kontraktuara të bëhet vetëm përmes procedurave të rregullta të amandamentimit, me arsyetim të dokumentuar, aprovimet e nevojshme paraprake dhe zotimin e mjeteve, para se ndryshimet të zbatohen nga operatorët ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Nënshkrimi i kontratës me operatorin ekonomik të papërgjegjshëm

Gjetja Sipas nenit 40 pika 9 të Rregullores nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, Komisioni vlerësues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Tutje theksohet se nën a). Në rast se shuma e korigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B49. në rast se OE në fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjale do të refuzohet. AK gjithashtu duhet të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. Ndërsa nën b). Theksohet se në rast se shuma e korigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminojë OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42.

Tek kontrata për projektin “Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush”, në vlerë të kontraktuar prej 18,162,896€, gjatë procesit të vlerësimit të tenderit kemi vërejtur se në paramasën dhe parallogarinë e ofertës së operatorit ekonomik fitues kishte gabime në përlllogaritjen e nëntotaleve.

Kjo kishte ndodhur pasi gjatë përlllogaritjes nuk ishin përfshirë:

- pozicioni 11 “Punët e strukturës së Katedrales” në kuadër të Sheshit Katedralja 01, në vlerë prej 1,176,403€; dhe
- pozicioni 11 “Punët e fontanës” në kuadër të Sheshit të Koncerteve 05, në vlerë prej 103,056€.

Si rezultat, vlera totale e ofertës e përlllogaritur nga operatori ekonomik kishte rezultuar 18,162,896€, ndërsa pas përfshirjes së këtyre pozicioneve, të cilat ishin pjesë e paramasës dhe parallogarisë së tenderit, vlera totale rezulton 19,442,355€, apo 1,279,459€ më shumë. Diferenca e identifikuar përfaqëson rreth 7% të vlerës së ofertës dhe tejkalon pragun e lejuar prej +/- 2% të përcaktuar me rregullore.

Përkundër kësaj, komisioni i vlerësimit nuk kishte identifikuar dhe trajtuar gabimet aritmetike sipas kërkesave të rregullores, kishte rekomanduar operatorin ekonomik për shpërblim të kontratës dhe kontrata ishte nënshkruar bazuar në vlerën e pakorigjuar të ofertës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të formulës së gabuar në paramasë, e cila kishte përjashtuar këto pozicione nga përlllogaritja e nëntotaleve, si dhe për shkak të mosidentifikimit dhe mosvlerësimit të drejtë të gabimeve aritmetike

nga komisioni i vlerësimit dhe mungesës së kontrolleve efektive gjatë procesit të ekzaminimit të ofertës.

Ndikimi

Mosidentifikimi dhe mosveprimi sipas kërkesave të rregullores për gabimet aritmetike mbi prapun e lejuar rrit rrezikun e vlerësimit jo të drejtë të ofertave dhe trajtimit jo të barabartë të operatorëve ekonomik, si dhe mund të ndikoj në shpërblimin e kontratës në kundërshtim me kërkesat e prokurimit publik, duke cenuar integritetin dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit publik dhe duke rritur rrezikun e kontraktimit joekonomik dhe dëmtimit financiar të Komunës.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë që komisionet e vlerësimit të verifikojnë në mënyrë të plotë dhe të saktë përlogaritjet në paramasë dhe parallogari, si dhe të zbatojnë kërkesat e rregullores për trajtimin e gabimeve aritmetike, duke eliminuar ofertat në rastet kur diferencat tejkalojnë prapun e lejuar prej 2%.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C2 - Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike

Gjetja

Sipas nenit 2.1 të Rregullores MF-nr. 04/2017, financimi publik i projekteve dhe programeve të OJQ-ve duhet të bëhet përmes thirrjes publike dhe vetëm për OJQ-të që i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se Komuna kishte financuar Federatën e Futbollit të Kosovës, e cila ka statusin e organizatës joqeveritare, në vlerë prej 40,000€ për realizimin e projektit “Liga e shkollave të Prishtinës”.

Për këtë qëllim, më 29.04.2025 Kryetari i Komunës kishte nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me Federatën e Futbollit të Kosovës. Megjithatë, nga dokumentacioni i siguruar nuk rezulton se ishte paraqitur kërkesë nga përfituesi, se projekti ishte shqyrtuar dhe vlerësuar, si dhe se ishte zhvilluar procedurë e thirrjes publike për përzgjedhjen e projektit. Si rrjedhojë, financimi në vlerë prej 40,000€ ishte realizuar pa dëshmi për përmbushjen e procedurave të kërkuara për financimin publik të OJQ-ve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i financimit përmes marrëveshjes së bashkëfinancimit, pa u siguruar zbatimi i procedurave dhe dokumentacionit të kërkuar për financimin e OJQ-ve.

Ndikimi

Financimi i OJQ-ve pa thirrje publike zvogëlon transparencën dhe konkurrencën e barabartë, si dhe rrit rrezikun që mjetet publike të ndahen pa vlerësim të dokumentuar të nevojës, arsyeshmërisë dhe përfitimit për Komunën.

Rekomandimi C2

Kryetari duhet të sigurojë që çdo financim për OJQ, përfshirë marrëveshjet e bashkëfinancimit, të realizohet vetëm përmes procedurave të përcaktuara me Rregulloren MF-nr. 04/2017, duke siguruar thirrje publike, dokumentim të kërkesës, vlerësim nga komisioni përkatës dhe dëshmi të qarta për qëllimin dhe përfitimin e Komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C3 - Realizimi i sasive në kontratën publike kornizë, në mospërputhje me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit**Gjetja**

Sipas nenit 17.35 të Rregullores nr.001/2022 për prokurimin public, Kurdo që Autoriteti Kontraktues nuk din sasisë indicative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktojë peshët në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve/artikujve” në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në bazë të poentimit.

Si rrjedhojë, peshimi I artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshojë nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit.

Në kontratën publike kornizë “Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave komunale”, me vlerë të parashikuar prej 1,000,000€, kategoria A e specifikave ishte peshuar me 90% të kontratës, përkatësisht me lejim të shpenzimit deri në vlerë prej 900,000€. Megjithatë, kjo kategori ishte tejkaluar duke u realizuar në vlerë prej 1,233,762€, apo 137% të vlerës së lejuar.

Për më tepër, totali i pagesave kishte arritur në 1,282,972€, që përfaqëson tejkalim prej 28% të vlerës së kontratës. Kjo bie ndesh me parimin ligjor që në kontratat kornizë me peshim nuk aplikohet toleranca +/-30%, si në kontratat me sasi indikative.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave, përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësisë së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit, si dhe mungesës së kontrollit nga menaxheri i kontratës gjatë zbatimit të saj.

Ndikimi

Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës së përcaktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo për shkak se vendimi për dhënien e kontratës është bazuar në një strukturë çmimi të balancuar sipas peshës së parapara, ndërsa gjatë realizimit ato nuk janë respektuar.

Si pasojë, komuna rrezikon planifikimin buxhetor duke hyrë në obligime shtesë të paparashikuara.

Rekomandimi C3

Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, të bëhet një vlerësim i saktë i nevojave reale të komunës gjatë përgatitjes së kërkesave për tender dhe peshat e specifikuar në dosjet e tenderit të reflektojnë rëndësinë dhe vëllimin e pritshëm të shërbimeve që do të kryhen në praktikë. Gjatë zbatimit të kontratës, menaxherët e kontratave të monitorojnë zbatimin sipas peshave të miratuara, për të garantuar përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe objektivat buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2025 ishin në vlerë prej 42,879,694€. Ato lidhen me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje ndërtimi, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, taksat për mbeturina dhe taksat e infrastrukturës.

Çështja B10 - Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për lejet ndërtimore

Gjetja Ligji nr. 04/L-110 për ndërtim, neni 17 pika 1.2 përcakton se leja ndërtimore duhet të lëshohet brenda 30 ditëve nga pranimi i kërkesës për kategorinë I dhe brenda 45 ditëve për kategorinë II dhe III.

Në gjashtë raste të testuara kemi vërejtur se Komuna nuk ka respektuar afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore. Vonesat në shqyrtimin e lejeve ndërtimore kanë ndodhur prej gjashtë muaj deri në tri vite.

Vonesat në shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore kanë ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së mbikëqyrjes.

Ndikimi Shqyrtimi i vonuar i kërkesave për leje ndikon negativisht në arkëtimin me vonesë të të hyrave që burojnë nga këto shërbime si dhe në mungesën e shërbimeve të rregullta dhe me kohë për qytetarët.

Rekomandimi B10 Kryetari duhet të analizojë shkaqet e vonesave të shqyrtimin e lejeve ndërtimore, dhe të marrë masa që ato të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A7 - Mangësi në shpërndarjen e pagesave tatimore

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 23, paragrafi 14, pagesat e bëra për shlyerjen e detyrimeve tatimore duhet të shpërndahen proporcionalisht për të përmbushur detyrimet që burojnë nga njësitë dhe/ose parcelat përkatëse.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se në disa raste pagesat e realizuara nga tatimpaguesit nuk ishin shpërndarë saktë në kartelat e detyrimeve tatimore. Si rezultat, një pjesë e pagesave kishte mbetur e pushpërndarë në sistem dhe ishte paraqitur si borxh i papaguar në kartelën financiare të tatimpaguesit, edhe pse pagesa ishte realizuar. Në shtatë raste të identifikuar, vlera e pagesave të pushpërndara ishte 996€.

Ndër rastet me vlera më të larta ishin:

- Pagesa prej 14,397€ ishte shpërndarë në vlerë prej 13,873€, ndërsa diferenca prej 524€ ishte evidentuar si borxh i papaguar; dhe

- Pagesa prej 1,370€ ishte shpërndarë në vlerë prej 1,042€, ndërsa diferenca prej 328€ ishte evidentuar si borxh i papaguar.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mangësive në procesin e regjistrimit dhe shpërndarjes së pagesave në kartelat financiare të tatimpaguesve nga Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, pas ndryshimit të sistemit të tatimit në pronë, si dhe mungesës së kontrolleve dhe verifikimeve të rregullta ndërmjet pagesave të realizuara dhe shpërndarjes së tyre sipas prioriteteve të përcaktuara.

Ndikimi

Mos shpërndarja e saktë e pagesave ndikon në paraqitjen jo të drejtë të gjendjes së detyrimeve tatimore në kartelat financiare të tatimpaguesve, duke rezultuar me evidentimin e borgjeve jo reale për tatimpaguesit që kanë kryer pagesat e tyre. Po ashtu, kjo mund të ndikojë në rritjen e ankesave dhe pakënaqësive të tatimpaguesve, si dhe në ngarkimin e tyre me obligime shtesë apo procedura për borxhe që realisht janë të paguara.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të sigurojë verifikimin dhe harmonizimin e pagesave të realizuara me shpërndarjen e tyre në kartelat financiare të tatimpaguesve, në mënyrë që të eliminohen dallimet dhe të sigurohet paraqitje e saktë e detyrimeve tatimore. Gjithashtu, Komuna, në bashkëpunim me Departamentin e Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit për regjistrimin dhe shpërndarjen e pagesave, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 46,494,138€, prej të cilit janë shpenzuar 46,474,720€ apo 99.9%. Numri i pozitave të aprovuara sipas Ligjit të Buxhetit ishte 4,860, ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarve ishte 4,804.

Çështja B11 - Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik

Gjetja	<p>Neni 34 i Rregullores (QRK) nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil përcakton “Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje”.</p> <p>Po ashtu neni 102 pika i Ligjit nr. 08/l-197 për zyrtarët publik përcakton “Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës”.</p> <p>Gjatë auditimit kemi vërejtur se Komuna ende nuk e kishte hartuar rregulloren për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, si parakusht për harmonizimin e kontratave të punës me kuadrin e ri ligjor. Në 29 raste kontratat nuk ishin të azhurnuara sa i përket koeficienteve dhe elementeve tjera të përcaktuara me Ligjin për zyrtarët publik. Si rrjedhojë, zyrtarët publikë vazhdojnë të kenë kontrata të pa harmonizuara me ligjin dhe rregulloret në fuqi.</p> <p>Mos azhurnimi i kontratave ka ardhur si rezultat i mos hartimit me kohë të rregullores për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, e cila është një kusht paraprak për zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publik në aspektin e kontratave dhe koeficienteve të ri.</p>
Ndikimi	<p>Mos azhurnimi i kontratave të punës dhe mospërputhja me sistemin e ri të koeficienteve ka shkaktuar mosrespektim të kërkesave ligjore dhe ka ndikuar në mos përfshirjen e saktë të pozitave në strukturën e pagave.</p>
Rekomandimi B11	<p>Kryetari duhet të përshpejtojë finalizimin dhe miratimin e rregullores për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, në mënyrë që të mundësohet azhurnimi i kontratave të punës në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publik.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 72,273,820€, prej tyre në 2025 ishin shpenzuar 71,481,931€ apo 98.9%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve arsimore, kulturore, fushave sportive, ndërtimin dhe riparimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen investive.

Çështja A8 - Dobësi në zbatimin e projekteve kapitale gjatë verifikimit në terren

Gjetja

Sipas paragrafit 1 të nenit 31 të Ligjit të Prokurimit Publik (Ekzekutimi i kontratave) përcaktohet se Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet, me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit shtatë dhe janë paraqitur në dosjen e tenderit.

Sipas paragrafit 1 nenit 69 të këtij Ligji në lidhje me aftësitë teknike dhe/ose profesionale theksohet se Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Gjatë verifikimit fizik të projekteve kapitale janë identifikuar mangësi që lidhen me zbatimin e kontratave dhe mbikëqyrjen e punimeve, si në vijim:

1. Te projekti “Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush”, kontrata e nënshkruar më 06.02.2025 ë vlerë prej 18,162,896€, gjatë verifikimit fizik të kryer më 07.05.2026, është vërejtur se menaxheri i projektit i angazhuar në terren nuk ishte i njëjtë me personin e deklaruar në ofertën e operatorit ekonomik fitues. Për këtë ndryshim nuk ishte siguruar kërkesë apo aprovim për zëvendësimin e stafit kyç.

2. Te projekti “Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender”, kontrata e nënshkruar më 20.05.2024 në vlerë prej 2,847,777€, gjatë verifikimit fizik të kryer më 12.05.2026, është vërejtur se menaxheri i projektit i angazhuar në terren nuk ishte i njëjtë me personin e deklaruar në ofertën e operatorit ekonomik fitues. Për këtë ndryshim nuk ishte siguruar kërkesë apo aprovim për zëvendësimin e stafit kyç.

Në të dy rastet e mësipërme, stafi kyç i paraqitur për të dëshmuar kapacitetin profesional gjatë procedurës së tenderimit nuk ishte i njëjtë me stafin që po e zbatonte kontratën në praktikë.

3. Te projekti “Ndërtimi i rrugës A - pjesa e parë”, kontrata e nënshkruar më 24.03.2023 në vlerë prej 8,497,801€, gjatë verifikimit fizik kemi vërejtur se disa pozicione të paguara nuk ishin të vendosura në terren. Koncretisht, tek pagesa në vlerë prej 341,201€, për pozicionin 1.4.13 “Furnizimi, transporti dhe vendosja e gurëve natyral me dimensione 10/10/10 cm dhe 20/20/10 cm”, ishin paguar 2,835m² në vlerë prej 138,915€, ndërsa në terren mungonin afërsisht 1,200m². Po ashtu, për pozicionin 1.4.16 “Furnizimi, bartja, prerja dhe vendosja e skajoreve 7/20/50”, ishin paguar 5,435m në vlerë prej 76,090€, ndërsa në terren mungonin afërsisht 800m².

Sipas zyrtarëve përgjegjës, këto pozicione ishin larguar/demoluar si rezultat i fillimit të ndërtimit të një kompleksi banesor në afërsi të rrugës dhe trotuarit. Kompania private kishte marrë leje nga Drejtoria e Urbanizimit për

zhvillimin e punimeve ndërtimore dhe kishte shfrytëzuar segmentin e trotuarit për qarkullim të materialit dhe mekanizmit, si dhe për parkim/deponim, duke dëmtuar punimet e realizuara dhe të paguara më parë në kuadër të ndërtimit të rrugës. Ndërkohë, investitor i projektit “Ndërtimi i rrugës A” ishte vetë Komuna, ndërsa lejet për punimet private dhe për projektin publik ishin lëshuar nga i njëjti institucion komunal, përkatësisht Drejtoria e Urbanizmit. Aktualisht, ky segment nuk është i lirë për vazhdimin e punimeve dhe pozicionet e demoluara mbesin të porealizuara në funksion.

Mangësitë e identifikuara kanë ardhur si pasojë e monitorimit jo të mjaftueshëm të zbatimit të kontratave dhe mungesës së kontrolleve efektive për të siguruar angazhimin e stafit kyç gjatë realizimit të punimeve. Po ashtu, ka munguar koordinimi ndërmjet drejtorive komunale lidhur me zhvillimin paralel të punimeve publike dhe private në të njëjtin lokacion. Komuna, edhe pse investitor i projektit të rrugës, kishte lëshuar leje ndërtimi për kompleksin privat pa siguruar masa për mbrojtjen e punimeve të realizuara në projektin kapital.

Ndikimi

Mos angazhimi i stafit kyç të deklaruar në ofertë rrit rrezikun që punimet të mos realizohen sipas kapaciteteve profesionale të vlerësuara gjatë tenderimit. Gjithashtu, dëmtimi i punimeve të paguara dhe mos ruajtja e tyre deri në përfundimin final të projektit mund të rezultojë me kosto shtesë, vonesa në realizimin e projekteve dhe ulje të cilësisë së investimeve kapitale.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të sigurojë monitorim dhe kontrolle më efektive gjatë zbatimit të kontratave, me qëllim që stafi kyç i deklaruar në ofertë të jetë i angazhuar gjatë realizimit të punimeve ose çdo ndryshim të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe kontraktuale. Po ashtu, duhet të sigurohet koordinim më i mirë ndërmjet drejtorive komunale, në mënyrë që të shmangen dëmtimet apo pengesat gjatë zhvillimit paralel të projekteve private dhe atyre kapitale të Komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PFV ishte 2,573,261,986€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale ishte 3,175,228€ dhe e stoqeve 1,090,402€.

Çështja B12 - Dobësi në inventarizimin, vlerësimin e pasurisë dhe pasqyrimin e pasurisë nën 1,000€ dhe stoqeve

Gjetja

Neni 19.4.3 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare përcakton se në fund të çdo viti duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen sipas regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa, sipas nenit 24, pas barazimit të gjendjes së inventarizuar dhe të vlerësuar me gjendjen sipas regjistrave, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të përfshihet në pasqyrat vjetore financiare, në pajtim me Rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare.

Po ashtu, sipas nenit 6, pika 3 të kësaj rregulloreje, pasuritë jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen dhe menaxhohen përmes programit e-pasuria.

Gjatë auditimit të menaxhimit të pasurisë kemi identifikuar këto mangësi:

- Komuna ka caktuar me vonesë komisionin për inventarizimin e pasurisë, përkatësisht më 30.03.2026, ndërsa komisioni për vlerësimin e pasurisë nuk është caktuar fare. Si rezultat, procesi i inventarizimit nuk është përfunduar me kohë para përgatitjes së PVF-ve. Deri në kohën e auditimit (maj 2026), vetëm tri drejtori kishin dorëzuar raportet e inventarizimit. Për shkak të kësaj, nuk është përgatitur raporti përmbledhës i inventarizimit dhe nuk është bërë krahasimi ndërmjet gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurive, siç kërkohet me nenet 19 dhe 24 të rregullores. Si rrjedhojë, gjendja e inventarizuar dhe e vlerësuar e pasurisë nuk ka mundur të reflektohet saktë në PVF.

- Gjithashtu, pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe stoqet nuk janë raportuar as gjatë këtij viti në pasqyrat financiare përmes sistemit e-pasuria. Raportimi financiar është bazuar në regjistra manualë (Excel), të cilët mirëmbahen nga zyrtari i pasurisë, e jo përmes sistemit E-pasuria.

- Po ashtu, nga një pagesë në vlerë prej 24,482€ e realizuar në vitin 2024, vetëm 14,841€ ishin evidentuar në regjistrat në Excel si pasuri nën 1,000€, ndërsa shuma prej 9,641€, e cila i përkiste materialit shpenzues të dërguar në Drejtorinë e Arsimit, nuk ishte regjistruar fare në regjistrin e stoqeve. Kjo çështje ishte adresuar edhe si rekomandim në vitin paraprak.

Këto mangësi kanë ardhur si rezultat i moszbatimit me kohë të kërkesave të Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare, mungesës së kontrolleve efektive për harmonizimin e gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurive, si dhe mungesës së përdorimit të plotë të sistemit e-pasuria. Si rezultat, raportimi i pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve ka vazhduar të realizohet përmes regjistrave manualë dhe janë evidentuar raste të mos regjistrimit të materialeve shpenzuese dhe stoqeve, mangësi këto që po përsëriten ndër vite.

Ndikimi

Këto mangësi kanë ardhur si rezultat i moszbatimit me kohë të kërkesave të Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare, mungesës së kontrolleve efektive për harmonizimin e gjendjes së

inventarizuar me regjistrat e pasurive, si dhe mungesës së përdorimit të plotë të sistemit e-pasuria. Si rezultat, raportimi i pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve ka vazhduar të realizohet përmes regjistrave manualë dhe janë evidentuar raste të mos regjistrimit të materialeve shpenzuese dhe stoqeve, mangësi këto që po përsëriten ndër vite.

Rekomandimi B12 Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e plotë të kërkesave të Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare, duke siguruar përfundimin me kohë të procesit të inventarizimit, harmonizimit e gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurisë, si dhe përdorimin e plotë të sistemit e-pasuria për regjistrimin dhe raportimin e pasurive dhe stoqeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B13 - Dobësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive

Gjetja Neni 11 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim", "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi".

Ndërsa, sipas nenit 8 pika 4 thekson se Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në përputhje me kontratën apo urdhërblertjen.

Gjatë auditimit kemi identifikuar pasaktësi në regjistrimin dhe përditësimin e informatave në regjistrin kontabël të pasurisë, si rezultat i klasifikimit jo të duhur të investimeve në vijim dhe pasurive në përdorim, mungesës së informatave të plota lidhur me statusin e projekteve, si dhe mos aplikimit të saktë të zhvlerësimit. Rastet e identifikuara janë si në vijim:

- Një transfer në vlerë prej 5,120,000€ i realizuar gjatë vitit 2024, në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe UNDP-së për projektin "Modernizimi i arsimit përmes inovacionit dhe trashëgimisë kulturore", i cili ndërlidhet me projektet në Qendrën "Gërmia" dhe objektet e "Tulltores", ishte regjistruar në regjistrat e pasurisë si pasuri në përdorim - objekte kulturore. Megjithatë, dy projektet edhe gjatë vitit 2025 nuk kishin përfunduar në tërësi dhe pasuritë përkatëse ende nuk ishin pranuar nga komuna. Si rezultat, regjistrimi i këtyre mjeteve si pasuri në përdorim nuk ishte në përputhje me kërkesat për njohjen dhe regjistrimin e pasurive kapitale.

- 15 pagesa në vlerë totale prej 2,347,888.50€, që kanë të bëjnë me shërbimet e konsulencës së Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës, ishin regjistruar si një regjistrim individual në kategorinë "investime në vijim", përkundër faktit se ato lidhen me projekte të ndryshme

dhe ndodhen në faza të ndryshme të realizimit. Këto pagesa do të duhej të ndaheshin dhe regjistroheshin sipas projekteve përkatëse, me qëllim të pasqyrimin të saktë të gjendjes së investimeve dhe avancimit të secilit projekt.

- Projekti në vlerë prej 300,000€, i regjistruar si investim në vijim, ka të bëjë me pagesën e realizuar në vitin 2021 në bazë të Letrës së Mirëkuptimit ndërmjet Lux Development, Komunës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Sipas marrëveshjes, Komuna ishte paraparë të bashkëfinancojë projektin për ndërtimin/renovimin e QK për TIK në vlerë prej 300,000€, ndërsa Dukata e Madhe e Luksemburgut do të financojë pjesën prej 1,214,761.37€. Ky projekt ende figuron në regjistrat e pasurisë si investim në vijim. Megjithatë, deri në fazën e auditimit (maj 2026) nuk kemi pranuar përgjigje apo dëshmi lidhur me statusin e realizimit dhe përfundimit të projektit. Në mungesë të këtij informacioni, nuk kemi mundur të vlerësojmë nëse projekti duhet të vazhdojë të mbahet si investim në vijim apo të regjistrohet në kategorinë përkatëse të pasurisë.

Gjatë testimit të pasurive kapitale kemi vërejtur se vlera e raportuar në PVF ishte mbivlerësuar për 884,083€, ndërsa ishte nënvlerësuar për 371,344€, si rezultat i rasteve në vijim:

- Në një rast, pagesa në vlerë prej 200,000€, e regjistruar si investim në vijim, lidhet me Marrëveshjen e bashkëfinancimit ndërmjet Komunës dhe Manifesta 14, të datës 15.11.2021, për projektin “Ripërdorimi dhe menaxhimi i ish Bibliotekës Hivzi Sylejmani”. Sipas marrëveshjes, Manifesta 14 kishte rolin e partnerit zbatues dhe menaxhues të prokurimit, ndërsa Komuna merrete pjesë si bashkëfinancuese.

Nga informatat e siguruara gjatë auditimit, është konstatuar se përveç kontributit të Komunës, Manifesta 14 kishte bashkëfinancuar projektin në vlerë prej 250,000€. Duke marrë parasysh vlerën totale neto të projektit deri në fund të vitit 2025 prej 412,500€, pasuria e regjistruar nga Komuna është nënvlerësuar për 212,500€.

- Në tri raste, investimet në vijim nuk ishin trajtuar dhe klasifikuar saktë pas përfundimit të projekteve kapitale. Në dy prej këtyre raste, pasuritë në vlerë prej 200,674€ janë të regjistruara si investime në vijim, edhe pse projektet kishin përfunduar dhe ato do të duhej të transferoheshin në kategorinë e pasurive në përdorim. Si rezultat, nuk ishte aplikuar zhvlerësimi në vlerë neto prej 74,564€, duke ndikuar në mbivlerësimin e pasurive për këtë shumë. Ndërsa, në rastin tjetër, për shkak të trajtimit jo të duhur të një projekti të përfunduar si investim në vijim, pasuria ishte nënvlerësuar për 81,870€. Si rezultat, ndikimi neto në regjistrin e pasurisë kishte nënvlerësim prej 7,306€.

- Në tri raste, pasuritë në vlerë prej 809,518€ ishin të regjistruara si investime në vijim, edhe pse vlerat e tyre tashmë ishin përfshirë në regjistrin e pasurive si pasuri në përdorim. Si rezultat, pasuritë ishin mbivlerësuar për shumën prej 809,518€.

- Në një rast, pasuria e regjistruar si pasuri në përdorim për tri pagesa në vlerë neto prej 183,207€, në fakt do të duhej të regjistrohej në vlerë neto prej 260,181€. Si rezultat, pasuria ishte nënvlerësuar për 76,974€.

- Në një rast, pesë pagesa në vlerë bruto prej 493,837€ ishin regjistruar si pasuri në përdorim dhe ndaj tyre ishte aplikuar zhvlerësimi në vlerë prej 331,869€, ndonëse ato do të duhej të regjistroheshin si investime në vijim.

Për këto pagesa nuk kemi pranuar informata lidhur me statusin e realizimit dhe përfundimit të projektit, prandaj nuk kemi mundur të vlerësojmë nëse trajtimi kontabël dhe zhvlerësimi i aplikuar ishin të sakta.

Si rezultat i këtyre rasteve, regjistri kontabël i pasurisë dhe vlera e raportuar e pasurive në PVF nuk paraqesin në mënyrë të saktë gjendjen reale të pasurive kapitale të komunës.

Dobësitë në kontrollet e brendshme për menaxhimin e pasurive, mungesa e harmonizimit të regjistrave me dokumentacionin mbështetës, si dhe menaxhimi dhe arkivimi jo i duhur i dokumentacionit të projekteve, kanë ndikuar në pasaktësi në regjistrimin, klasifikimin dhe përditësimin e informatave në regjistrin kontabël të pasurisë. Edhe pse janë ndërmarrë veprime për mbylljen e disa projekteve të trajtuara si investime në vijim, ende kanë mbetur projekte dhe regjistrime që nuk janë përditësuar sipas statusit të tyre real.

Ndikimi Pasaktësitë në regjistrimin, klasifikimin dhe përditësimin e informatave të pasurisë kanë ndikuar që investimet në vijim, pasuritë në përdorim dhe zhvlerësimi të mos paraqiten saktë në regjistrin kontabël dhe në PVF. Si rezultat, vlera e pasurive është mbivlerësuar ose nënvlerësuar, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare.

Rekomandimi B13 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive, në mënyrë që regjistrimi, klasifikimi dhe përditësimi i informatave në regjistrin e pasurisë të bëhet saktë dhe në përputhje me statusin real të projekteve. Po ashtu, duhet të sigurohet harmonizimi i vazhdueshëm i regjistrave të pasurisë me dokumentacionin mbështetës, mbyllja dhe transferimi me kohë i investimeve në vijim pas përfundimit të projekteve, si dhe aplikimi i saktë i zhvlerësimit, me qëllim të paraqitjes së drejtë të pasurive në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.5 Të arkëtueshmet

Komuna e Prishtinës në PFV-të e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 91,764,526€. Kjo vlerë kryesisht përbëhet prej tatimit në pronë në vlerë 58,550,623€, taksat nga mbeturinat në vlerë 16,072,680€, taksa nga lejet e ndërtimit në vlerë 7,456,904.65€ dhe taksa tjera në vlerë 9,684,318€. Gjatë vitit 2025, llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë janë rritur për 9,336,596€ ose 19% krahasuar me vitin 2024.

Çështja B14 - Mangësi në menaxhimin e arkëtimit të borgjeve

Gjetja

Bazuar në rregulloren mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës nr. 01-434/01-0094474/17 të datës 24.04.2017, neni 13 përcakton mënyrën dhe afatet e pagesës, për pagesat me tri këste “Afati për përmbushjen e obligimit do të jetë dymbëdhjetë (12) muaj, kurse për pagesat me katër këste “ Afati për përmbushjen e obligimit do të jetë tetëmbëdhjetë (18) muaj nga dita e marrjes së dorëzimit të lejes së ndërtimit.

Po ashtu Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave të Komunës së Prishtinës e datës 01.12.2023, neni 18 përcakton se në rast se një debitor nuk kryen pagesën e tarifës për mbeturina, komuna ka të drejtë të ndërmarr veprime ligjore përmes procedurës gjyqësore në gjykatën kompetente ose përmes përmbaresit privat, me qëllim të mbledhjes së borgjeve të pa mbledhura.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2025 janë raportuar në vlerë prej 91,764,526€. Prej tyre, 16,072,680€ apo 18% ishin taksa të pambledhura për mbeturina, të evidentuara deri në qershor 2025, pasi nga kjo periudhë të drejtën e faturimit dhe arkëtimit e ka marrë KRM “Pastrimi”.

Po ashtu, 7,456,905€ apo 7% ishin taksa të pambledhura nga lejet e ndërtimit, të krijuara kryesisht gjatë viteve 2008-2023. Përkundër afateve të përcaktuara me rregullore për pagesë me këste, këto borgje vazhdojnë të evidentohen në regjistrat e llogarive të paarkëtuara.

Komuna gjatë vitit 2025 nuk kishte ndërmarrë veprime konkrete për mbledhjen e këtyre borgjeve, në përputhje me kërkesat rregullative.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve nga departamentet përgjegjëse për mbledhjen e borgjeve, si dhe mungesës së një strategjie efektive për inkasim dhe monitorim të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mosrealizimi i të hyrave të planifikuara rrit rrezikun e mosrealizimit të projekteve të financuara nga burimet vetanake. Po ashtu, vjetërsia e llogarive të arkëtueshme e vështirëson dhe në disa raste e pamundëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B14

Kryetari duhet të siguroj forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe veprimit për mbledhjen e borgjeve, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë procedurat përmbare dhe gjyqësore, me qëllim të rritjes së efikasitetit në menaxhimin dhe inkasimin e të hyrave vetanake.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit janë identifikuar disa çështje të cilat i janë komunikuar menaxhmentit dhe janë adresuar në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Si rezultat, ato nuk kërkojnë veprime të mëtejshme dhe paraqiten vetëm për qëllime dokumentimi të komunikimit, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të arritura. Këto përfshijnë:

Çështja 1

Korrigjimi i Pasqyrave Vjetore Financiare

Gjetja

Në PVF për vitin 2025 janë evidentuar mangësi në prezantimin e disa zërave financiarë. Konkretisht, tek Neni 13 nuk ishte shpalosur vlera prej 4,560€ tek pranimet tjera dhe shfrytëzimi i fondeve që kanë të bëjnë me kthimin e depozitave nga shpronësimet. Po ashtu, tek raporti i ekzekutimit të buxhetit - Neni 14, në shënimin nr. 8 (të hyrat tatimore) ishte evidentuar nënvlerësim prej 64,770€, ndërsa tek shënimi nr. 9 (të hyrat jo tatimore) nënvlerësimi ishte 87,537€. Gjithashtu, në kolonat e buxhetit fillestar dhe final për të hyrat tatimore dhe jo tatimore ishin përdorur projeksionet sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2024, në vend të projeksioneve sipas Qarkores Buxhetore nr. 01/2025 dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2025-2027. Tek shënimi nr. 7 (të tjera) te dalja e parasë nuk ishte prezantuar kthimi i depozitave në vlerë prej 4,560€. Po ashtu, tek Neni 25 (Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave), në shpalosjen në Excel nuk ishin paraqitur informatat për tri vitet, ndërsa tek Nenet 26 dhe 27 nuk ishin prezantuar informatat për dy vitet paraprake, siç kërkohet me formatin e raportimit financiar.

Veprimi i kërkuar

Gjatë rishikimit të PVF-ve, auditori ka kërkuar nga Komuna që të korrigjojë pasqyrat vjetore financiare duke plotësuar dhe prezantuar në mënyrë të saktë të gjithë zërat financiarë, në përputhje me kërkesat e Rregullores MF Nr. 01/2017. Konkretisht, është kërkuar përfshirja e vlerës së munguar prej 4,560€ tek pranimet tjera dhe shfrytëzimi i fondeve, si dhe tek dalja e parasë - shënimi nr. 7 (të tjera), korrigjimi i nënvlerësimeve tek të hyrat tatimore dhe jo tatimore, përdorimi i projeksioneve sipas Qarkores Buxhetore nr. 01/2025 dhe KASH 2025-2027, si dhe plotësimi i shpalosjeve për Nenet 25, 26 dhe 27 me informatat për vitet paraprake sipas formatit të raportimit financiar.

Rezultati

Komuna ka ndërmarrë veprime dhe ka korrigjuar zërat e identifikuar në PVF, duke i ridorëzuar ato në Thesar më 25.02.2026. Me këtë rast janë adresuar mangësitë e evidentuara dhe është siguruar prezantim më i plotë dhe në përputhje me kërkesat e raportimit financiar.

Çështja 2

Transfer i mjeteve në llogari kryesore të Komunës

Gjetja

Me vendim të datës 02.09.2016, pagesat për anëtarësim të lexuesve në bibliotekën “Hivzi Sylejmani” janë realizuar përmes llogarisë bankare të bibliotekës. Ndërsa, nga viti 2017, sipas rregullave financiare pagesat e anëtarësimit realizohen direkt në degë të Bibliotekës dhe më pas transferohen në llogari kryesore të komunës. Megjithatë, mjetet e grumbulluara në periudhën paraprake në vlerë 31,261€ kanë mbetur në llogari të bibliotekës, me qëllim që të përdoren për realizimin e projekteve të bibliotekës. Mirëpo për shkak të rregullave financiare, projektet nuk ishin realizuar dhe mjetet e mbetura janë bartur nga viti në vit pa u shpenzuar.

Veprimi i kërkuar

Gjatë auditimit, çështja është diskutuar me zyrtarët përgjegjës dhe auditori ka kërkuar nga Biblioteka që të bëhet transferi i mjeteve në llogari kryesore të komunës si dhe mbyllja e llogarisë së veçantë e bibliotekës, me qëllim të evitimit të mbajtjes së panevojshme të mjeteve jashtë llogarisë kryesore. ndërsa sipas kërkesave komuna të mbështesë aktivitetet dhe projektet e bibliotekës nga llogaria kryesore përmes procedurave të rregullta financiare.

Rezultati

Zyrtarët përgjegjës nga biblioteka kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme, mjetet e pashfrytëzuara që barteshin ndër vite në një llogari të veçantë janë transferuar në llogari kryesore të komunës dhe llogaria e bibliotekës është mbyllur me 14.05.2026, gjithashtu është siguruar menaxhim i rregullt dhe transparent në përputhje me kërkesat e raportimit financiar.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	123,699,999	158,394,621	157,376,453	138,197,295	114,195,436
Grante Qeveritare - Buxheti	83,921,031	89,914,295	89,169,498	84,136,708	70,033,925
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	1,000,000	1,000,000	1,000,000	969,980	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	28,645,606	28,613,723	30,405,135	25,056,184
Të hyrat vetanake	38,778,968	38,778,968	38,559,324	22,671,402	19,105,328
Donacionet vendore	0	34,554	33,908	0	0
Donacionet e jashtme	0	21,198	0	14,070	0

Buxheti final i Komunës së Prishtinës është më i lartë se buxheti fillestar për 34,694,622€ apo 28%. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 5,993,264€, përfshirjes së të hyrave të bartura nga vitet paraprak në vlerë prej 28,645,606€ dhe donacioneve në vlerë prej 55,752€ në buxhet final.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	123,699,999	158,394,621	157,376,453	138,197,295	114,195,436
Pagat dhe mëditjet	40,499,674	46,494,138	46,474,720	43,879,580	39,574,435
Mallrat dhe shërbimet	28,200,000	30,942,755	30,926,416	29,833,925	29,344,958
Komunalitë	3,000,000	3,000,000	2,999,998	2,892,755	2,607,669
Subvencionet dhe transferet	5,500,000	5,533,908	5,493,388	5,232,457	5,143,898
Investimet Kapitale	46,350,325	72,273,820	71,481,931	56,358,577	37,524,476
Rezervat	150,000	150,000	0	0	0

Komuna kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Sqarimet lidhur me ndryshimet buxhetore janë paraqitur si në vijim:


- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,994,464€. Buxheti final përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 46,492,938€, dhe donacionet e jashtme prej 1,200€. Për periudhën janar - dhjetor 2025 realizimi i buxhetit është 99.9%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,742,755€. Pjesa më e madhe e këtij buxhetit përbëhet nga granti qeveritar prej 22,862,000€, të hyrave vetanake prej 5,338,000€, të hyrave të bartura prej 2,739,305€ dhe donacionet në vlerë prej 3,450€; Deri në fund të vitit 2025 realizimi i buxhetit ishte 99.9%;
- Buxheti final për shpenzime komunale përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 3,000,000€ dhe deri në fund të vitit realizimi i buxhetit ishte afër 100%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 33,908€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 3,000,000€, të hyrave vetanake prej 2,500,000€, dhe grantit të donacioneve të brendshme prej 33,908€. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte 99.8%;
- Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me buxhetin fillestar, kishte rritje në vlerë prej 25,923,495€. Ky buxhet përbëhet nga fondi i huamarrjes në vlerë prej 1,000,000€, fondi qeveritar prej 14,559,357€, të hyrat vetanake prej 30,740,968€, të hyrat vetanake të bartura prej 25,906,301€ dhe donacionet prej 17,194€. Deri në fund të vitit, Komuna kishte arritur të shpenzojë 71,481,931€, apo 98.9% të buxhetit final për investime kapitale.

Realizimi i lartë i buxhetit gjatë vitit 2025 është ndikuar edhe nga ekzekutimi i obligimeve përmes procedurave përmbartimore dhe vendimeve gjyqësore.

Vlen të theksohet se buxheti komunal për vitin 2025 ishte votuar me vonesë në Kuvendin Komunal gjatë muajit dhjetor 2024 dhe si pasojë nuk ishte miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Si rezultat, Komuna gjatë vitit kishte funksionuar me alokime mujore nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, bazuar në vlerat buxhetore të vitit paraprak. Këto kufizime buxhetore kishin krijuar vështirësi në menaxhimin financiar në të gjitha kategoritë ekonomike, sidomos për shkak të numrit të madh të pagesave të realizuara përmes procedurave përmbartimore dhe vendimeve gjyqësore, të cilat kishin ndikuar drejtpërdrejt në mjetet e disponueshme dhe nivelin e shpenzimeve.

Shuma e pagesave të realizuara përmes vendimeve gjyqësore gjatë vitit 2025 ishte 45,691,077€. Pjesa më e madhe e tyre lidhej me investimet kapitale, në vlerë prej 32,032,197€, ndërsa 8,820,556€ ishin nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, 2,880,222€ nga subvencionet dhe transferet, si dhe 1,952,824€ nga shpenzimet komunale. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e ekzekutimit të buxhetit gjatë vitit është realizuar përmes procedurave përmbartimore dhe vendimeve gjyqësore.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2025 ishin në vlerë prej 42,879,694€. Ato lidhen me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje ndërtimi, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, taksat për mbeturina dhe taksat e infrastrukturës.

Për vitin 2025, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 38,778,968€, vlerë e njëjtë me vitin paraprak. Krahasuar me vitin e kaluar, rritja më e theksuar në inkasimin e të hyrave ishte evidentuar tek të hyrat nga tatimi në pronë, të cilat kishin shënuar rritje prej 31%, si dhe tek të hyrat nga taksat për leje ndërtimi, të cilat kishin shënuar rritje prej 68%.

Përveç kësaj shume, të hyrat nga gjobat në trafik dhe gjobat nga Gjykatat ishin në vlerë prej 6,473,421€, të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Agjencia Pyjore e Kosovës, dhe më pas alokohen për shpenzim nga Komuna. Këto të hyra nuk janë përfshirë në tabelën e mëposhtme, pasi planifikimi dhe realizimi i tyre bëhet nga organizatat përkatëse të linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	38,778,968	38,778,968	42,879,694	32,342,571	34,728,204
Të hyrat tatimore	14,905,828	14,905,828	11,297,770	8,618,214	13,133,087
Të hyrat jo tatimore	23,873,140	23,873,140	31,565,538	23,708,938	21,587,700
Të hyrat tjera	0	0	16,386	15,419	7,417

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 të Komunës së Prishtinës ka rezultuar me 27 rekomandime kryesore. Komuna ka dorëzuar me vonesë planin e veprimit, konkretisht më 16.04.2026, në të cilin është paraqitur mënyra e planifikuar për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2025, tetë rekomandime janë zbatuar, tri ishin në proces, për 14 rekomandime nuk kishte filluar ende zbatimi, ndërsa dy rekomandime nuk ishin më të aplikueshme, siç është paraqitur në Grafikon 2 më poshtë.

Për përshkrim më të detajuar të rekomandimeve dhe mënyrën e trajtimit të tyre, shih Tabelën 3 (Tabela e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim të përmirësimit të procesit të menaxhimit dhe raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF.	Rekomandimi nuk është adresuar, pasi edhe kë vit kemi hasur në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme në PVF.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për konkluzion	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Drejtoria e Arsimit dhe ajo e Financave të vendosin mekanizma funksionalë të kontrollit për procesin e subvencionimit, duke garantuar përfshirjen dhe funksionimin e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit në përputhje me vendimin e miratuar. Po ashtu, duhet të zhvillohet një rishikim i plotë i subvencioneve të dhëna gjatë vitit 2024 për të identifikuar dhe adresuar përfitimet e pajustificuara. Në rastet kur konstatohet përfitim në kundërshtim me kriteret, të merren masa ligjore dhe administrative për kthimin e fondeve publike dhe përgjegjësinë e zyrtarëve të përfshirë.	Gjatë vitit 2025, nuk kemi hasur raste ku ka pasur parregullsi në menaxhimin e subvencioneve për kopshtet publiko-private. Si rezultat, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimi i fondeve publike të bëhet në përputhje të plotë me legjislacionin e aplikueshëm për menaxhimin e financave publike. Çdo kontraktim i punëve apo shërbimeve duhet të realizohet përmes procedurave të rregullta të prokurimit, ndërsa çdo pagesë duhet të mbështetet në një raport të pranimit të mallrave apo shërbimeve.	Rekomandimi konsiderohet i paaplikueshëm, pasi gjendja që ka qenë bazë për këtë rekomandim ka ndryshuar. Gjetja e vitit të kaluar kishte të bënte me dhënien e mjeteve në formë parapagimi, ndërsa gjatë vitit aktual nuk janë realizuar pagesa të tilla. Megjithatë, gjatë auditimit kemi rishikuar procesin e monitorimit të projektit, dhe çështjet e identifikuar janë trajtuar në kuadër të çështjes A3 - “Dobësi në menaxhimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e pronës komunale në kuadër të projektit ‘Modernizimi i arsimit përmes inovacionit dhe trashëgimisë’”.	Nuk është i aplikueshëm më

4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që procedura e negociuar pa publikim të përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe në përputhje të plotë me kushtet të përcaktuara në kërkesat ligjore. Para se të angazhojë operatorë privat, duhet të shqyrtohen kapacitetet me autoritetet publike, dhe të dokumentohen përpjekjet për bashkëpunim me to.	Në vitin 2025, nuk kemi hasur raste ku Komuna kishte aplikuar procedura të prokurimit me negociim në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik. Në rastet e testuara, ishin ofruar sqarimet dhe arsyetimet e nevojshme lidhur me përdorimin e këtyre procedurave. Si rezultat, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontrollet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore ka fonde të mjaftueshme buxhetore të ndara me ligjin për ndarjet buxhetore për të gjitha kontrata e lidhura.	Edhe gjatë këtij viti kemi hasur raste ku janë lidhur kontrata pa mjete të mjaftueshme financiare në dispozicion. Si rezultat, rekomandimi nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Baza për konkluzion	Komuna duhet të sigurojë që asnjë procedurë prokurimi për projekte ndërtimi të mos fillojë pa u pajisur më parë me lejen ndërtimore, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Ndërtim. Po ashtu, duhet të forcohen mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të vendosen kërkesa të qarta të bashkëpunimit ndërmjet drejtorive përkatëse në mënyrë që lejet për fillimin e punimeve të jepen para inicimit të procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave.	Edhe gjatë vitit 2025, Komuna kishte filluar procedura të prokurimit dhe kishte nënshkruar kontrata për projekte ndërtimore pa siguruar paraprakisht lejet e nevojshme ndërtimore, në kundërshtim me kërkesat ligjore në fuqi. Si rezultat, rekomandimi mbetet i pazbatuar.	Nuk ka filluar zbatim

7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që para inicimit të kontratave të reja, të bëhet një analizë e plotë e mbulueshmërisë së kontratave ekzistuese, për të shmangur mbivendosjen dhe dyfishimin e shërbimeve.	Gjatë vitit 2025, nuk kemi hasur raste ku janë lidhur kontrata për punë dhe shërbime të ngjashme, pavarësisht ekzistencës së kontratës aktuale. Si rezultat, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë krijimin dhe funksionimin e mekanizmave të qartë për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratave "Në shtëpi". Duhet të garantohet që çdo pagesë të realizohet vetëm pas verifikimit të plotë teknik, administrativ dhe financiar të furnizimeve. Po ashtu, duhet të dokumentohet dhe qartësohet përdorimi i mjeteve të mbetura ose të pashpenzuara dhe të sigurohet emërimi në kohë i menaxherëve të kontratave, për të parandaluar situata të ngjashme në të ardhmen.	Gjatë testimit të pagesave për vitin 2025, nuk kemi hasur raste me mangësi në zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratave "Në shtëpi". Si rezultat, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar
9.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.	Nuk janë ndërmarrë veprime për të klasifikuar drejtë shpenzimet nga kodet jo adekuate.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Të hyrat	Kryetari duhet të analizojë shkaqet e vonesave të shqyrtimit të lejeve ndërtimore dhe atyre mjedisore, dhe të marrë masa që ato të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprime në këtë drejtim.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që rekomandimet e dhëna nga komisionet përkatëse dhe të miratuara nga Kuvendi Komunal të zbatohen brenda afateve të përcaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Rekomandimi konsiderohet i zbatuar, pasi janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për menaxhimin e pronave të dhëna në shfrytëzim.	I zbatuar

12.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë funksionalizimin e plotë të regjistrimit elektronik të vijueshmërisë për të gjithë zyrtarët, pa përjashtime, dhe të ndërmerren masa për verifikim të rregullt dhe të pavarur të evidencave të pranisë në punë. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme në departamentin e pagave, në mënyrë që çdo ndryshim në statusin e zyrtarëve të reflektohet në kohë reale, dhe pagat të procesohen vetëm për periudhën kur ekziston angazhim i ligjshëm dhe dokumentuar. Në rastet kur janë bërë pagesa të pajustificuara, duhet të vendoset mënyra konkrete e kthimit të tyre në buxhetin e Komunës.	Nga auditimi i mostrave për vitin 2025, nuk kemi vërejtur raste të tilla. Si rrjedhojë, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar
13.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të përshpejtojë finalizimin dhe miratimin e rregullores për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, në mënyrë që të mundësohet azhurnimi i kontratave të punës në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publik.	Edhe gjatë vitit 2025 kemi hasur në raste ku nuk ishin bërë azhurnimet e kontratave të punës, ndërsa Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës ende nuk ishte miratuar.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha kontratat të menaxhohen dhe dokumentohen përmes modulit për menaxhimin e kontratës në sistemin e e-prokurimit në pajtim me kërkesat ligjore. Gjithashtu, të ndërmerren masa për forcimin e disiplinës administrative dhe monitorimit të brendshëm, në mënyrë që zyrtarët përgjegjës të përmbushin detyrimet që dalin nga legjislacioni në fuqi.	Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar, pasi nga testimi i mostrave kemi vërejtur se menaxhimi i kontratave ishte realizuar përmes platformës E-prokurimi.	I zbatuar
15.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, të bëhet një vlerësim i saktë i nevojave reale të komunës gjatë përgatitjes së kërkesave për tender dhe peshat e specifikuara në dosjet e tenderit të reflektojnë rëndësinë dhe vëllimin e pritshëm të shërbimeve që do të kryhen në praktikë. Gjatë zbatimit të kontratës, menaxherët e kontratave të monitorojnë zbatimin sipas peshave të miratuara, për të garantuar përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe objektivat buxhetore.	Edhe këtë vit kemi hasur në një rast ku është bërë tejkalimi i peshimit të sasive të realizuara tek kontratat kornizë. Si rrjedhojë, rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.	Pjesërisht i zbatuar

16.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve, të aplikohen thirrjet publike sipas kërkesave të rregullores në fuqi. Gjithashtu, të sigurohet se nënshkrimi i marrëveshjes mes komunës dhe përfituesit, të bëhet para pagesës së mjeteve.	Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar, pasi gjatë vitit aktual nuk janë identifikuar raste të subvencionimit pa thirrje publike të klubeve sportive me vendim të Kuvendit Komunal, siç ishte raportuar vitin e kaluar. Megjithatë, është evidentuar një rast i financimit të një OJQ-je përmes marrëveshjes së bashkëfinancimit të nënshkruar nga Kryetari, pa zhvilluar thirrje publike.	Pjesërisht i zbatuar
17.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë llogaridhënien lidhur me menaxhimin e projekteve kapitale, duke siguruar se për cdo ndryshim në termat dhe kushtet e kontratës, të zbatohen procedurat për marrjen e aprovimeve të duhura sipas rregullave të prokurimit të aplikueshme dhe amendamentimin e kontratës në pajtim me ndryshimet e bëra.	Rekomandimi nuk ishte zbatuar pasi që edhe këtë vit kemi hasur në raste ku janë ndryshuar pozicionet e kontratës pa aprovimet e duhura.	Nuk ka filluar zbatim
18.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit siç janë, pajisja me lejet e nevojshme për punë, zgjidhja e çështjeve pronësore, hartimi i mirëfilltë i projekteve ekzekutuese për t'u minimizuar kërkesat për punë të pa parapara, si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e vazhdueshme të progresit të projekteve, në mënyrë që punët të realizohen sipas planeve dinamike dhe sigurimet e ekzekutimit të ofruara nga operatorët ekonomik të mbulojnë periudhën deri në 30 ditë pas kompletimit të kontratës.	Nuk janë ndërmarrë veprime për të siguruar realizimin e projekteve kapitale sipas planit dinamik.	Nuk ka filluar zbatim

19.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të merret paraprakisht aprovimi nga Kuvendi Komunal, në përputhje me kërkesat ligjore	Edhe këtë vit Komuna kishte bërë pagesa në mungesë të aprovimit nga Kuvendi komunal nga shumat buxhetore të projekteve të tjera kapitale. Si rezultat, rekomandimi mbetet i pazbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
20.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi për procedimin e pagesave nga zyrtarët përgjegjës, në mënyrë që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerret urdhërblerja dhe më pas pranimit i mallrave/punëve.	Në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe Doracakun e brendshëm të auditimit, ky rekomandim nuk është i zbatueshëm.	Nuk është i aplikueshëm më
21.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.	Edhe gjatë vitit 2025 kemi identifikuar mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave. Megjithatë natyra e gjetjes dallon nga viti paraprak, dobësitë në zbatimin e kontrolleve gjatë vlerësimit të ofertave vazhdojnë të jenë të pranishme. Si rezultat, rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar	Pjesërisht i zbatuar
22.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Edhe këtë vit janë hasur pagesa për vendime gjyqësore dhe vonesa në kryerjen e obligimeve.	Nuk ka filluar zbatimin

23.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që të ndërmerren masa konkrete për përmirësimin e menaxhimit të pasurisë komunale, duke garantuar që regjistrimi, klasifikimi dhe përditësimi i të gjitha pasurive të bëhet në përputhje me gjendjen reale dhe kërkesat ligjore. Po ashtu, duhet të shqyrtohet nevoja për rritjen e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë, me qëllim të menaxhimit më efikas dhe më të saktë të pasurive.	Edhe këtë vit kemi hasur në pasaktësi në regjistrimin e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatim
24.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të përfshijë të gjitha njësitë organizative dhe të hartohet një raport përmbledhës që reflekton gjendjen reale të pasurisë. Gjithashtu, duhet të ndërmerren veprime konkrete për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet drejtorive dhe zyrtarëve përkatës, si dhe të sigurohet që të gjitha pasuritë jokapitale dhe stoqet të regjistrohen dhe raportohen përmes sistemit e-pasuria, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret në fuqi.	Rekomandimi nuk është zbatuar pasi raportimi i pasurisë nën 1,000€ dhe stoqeve për vitin 2025 është bërë përmes regjistrave excel e jo sistemit E-pasuria. Poashtu nuk është kryer inventarizimi para përgatitjes së pasqyrave financiare.	Nuk ka filluar zbatim
25.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe veprimin në procesin e arkëtimit të borxheve, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë procedurat përmbartimore dhe ato gjyqësore, me qëllim të rritjes së efikasitetit në menaxhimin e të hyrave vetanake.	Edhe gjatë vitit 2025 kemi vërejtur se nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për arkëtimin e borgjeve dhe trajtimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatim
26.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të zhvilluar një sistem të brendshëm të kontrollit për menaxhimin e detyrimeve kontingjente, përfshirë krijimin e një sistemi të mirëfilltë për lëndët gjyqësore dhe paditë në proces. Po ashtu, rekomandohet që zyra e financave dhe ajo ligjore të bashkëpunojnë ngushtë, me qëllim që çdo detyrim potencial të identifikohet, të vlerësohet në mënyrë të rregullt dhe të përfshihet në pasqyrat financiare me dokumentacion mbështetës adekuat.	Rekomandimi nuk është adresuar, pasi që edhe këtë vit kemi hasur në nënvlerësimin e detyrimeve kontingjente në PVF.	Nuk ka filluar zbatim

27.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha drejtoritë e audituara të përgatisin dhe dorëzojnë planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së, në përputhje me udhëzimet përkatëse. Ndërsa, NjAB duhet të zhvillojë dhe zbatojë një procedurë të qartë dhe të dokumentuar për ndjekjen dhe raportimin e progresit të rekomandimeve të dhëna, duke u bazuar në informata të verifikueshme.	Drejtoritë kishin përgatitur planet e veprimit, ndërsa NjAB kishte monitoruar zbatimin e rekomandimeve përmes përcjelljes së nivelit të zbatimit dhe sigurimit të dëshmive për veprimet e ndërmarra. Për rrjedhojë, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.	I zbatuar
-----	----------------------	---	---	-----------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nora Rashiti Nishefci, Udhëheqëse e ekipit



Refiqe Morina, Anëtare e ekipit



Lumni Mazreku, Anëtar i ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme në PFV	Komuna njofton se me datë 10.06.2026 ka nxjerrë vendime për lirim nga tatimi në pronë për katër raste ku tatimpagues ka qenë Kuvendi Komunal i Prishtinës dhe si dëshmi ka përcjellë vendimet përkatëse për lirim nga tatimi në pronë.	<p>Komenti i Komunës nuk e ndryshon gjetjen e auditimit. Vendimet për lirim nga tatimi në pronë janë nxjerrë më 10.06.2026, përkatësisht pas përfundimit të periudhës së audituar dhe pas identifikimit të çështjes nga auditimi.</p> <p>Për rrjedhojë, në datën e raportimit financiar, faturat e tatimit në pronë në vlerë prej 601,901€ vazhdonin të evidentoheshin si llogari të arkëtueshme, duke ndikuar në mbivlerësimin e tyre në PFV.</p> <p>Veprimet e ndërmarra nga Komuna paraqesin masa korrigjuese dhe duhet të evidentohen në planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve, por nuk e ndryshojnë gjendjen e konstatuar për periudhën e audituar. Për këtë arsye, gjetja mbetet e pandryshuar.</p>

<p>Gabime në llogaritjen e tarifave për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës</p>	<p>Për tri rastet e identifikuar, sqarimet janë si në vijim:</p> <p>1. sipas Aktvendimit 05 Nr. 351/02-5003/25, datë 03.04.2025, për shtëpi individuale të banimit me hapësirë 661.43m², tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës ishte llogaritur me 4.30€/m² në vend të 10.70€/m², duke dëmtuar komunën për 2,139€ - te ky rast zyrtari përgjegjës i lëndës sqaron se ka ndodhur lëshim nga ana e tij, dhe më pas edhe nga ana kontrolluesit. Si i tillë mund të konsiderohet si rast i izoluar. Zyrtari përgjegjës, në detyrë zyrtare, do të korrigjojë të njëjtin lëshim;</p> <p>2. sipas Aktvendimit 05 Nr. 351/02-157935/23, datë 19.04.2024, për ndërtesën B4, tek niveli ndërtimor PH, koeficienti për ballkon ishte llogaritur 0.25 në vend të 0.5, duke dëmtuar komunën për 620€ - te ky rast zyrtari përgjegjës i lëndës, pas verifikimit të aktit administrativ dhe pjesës grafike të bashkëngjitur, sqaron se ka ndodhur lëshim teknik në përshkrimin e destinimit të hapësirës, dhe atë në vend të “tarracë e pambuluar”, është shënuar “ballkon”, dhe se llogaria është në rregull, dhe</p> <p>3. sipas Aktvendimit 05 Nr. 351/02-11916/24, datë 19.03.2025, në llogaritjen e tarifës ishte përdorur përshkrimi “tarracë” pa u përcaktuar nëse bëhej fjalë për tarracë të mbuluar apo të pambuluar. Për më tepër, ishte aplikuar koeficienti i loxhes k=0.75, në vend të k=0.5 për tarracë të mbuluar ose k=0.25 për tarracë të pambuluar. Si rezultat, pala ishte dëmtuar për 962€ nëse tarracat ishin të pambuluara apo për 481€ nëse tarracat ishin të mbuluara - te ky rast zyrtari përgjegjës i lëndës, pas verifikimit të aktit administrativ dhe pjesës grafike të bashkëngjitur, sqaron se ka ndodhur lëshim teknik në përshkrimin e destinimit të hapësirës, dhe atë në vend të “loxhë”, është shënuar “tarracë”, dhe se llogaria është në rregull.</p>	<p>Për rastin e parë</p> <p>Komenti i Komunës nuk e ndryshon gjetjen e auditimit. Vetë komenti pranon se tarifa është llogaritur gabimisht me 4.30€/m² në vend të 10.70€/m², duke rezultuar në dëmtim të Komunës. Fakti që ju e konsideroni se rast i izoluar apo se do të korrigjohet më vonë, nuk e ndryshon gjendjen e konstatuar në kohën e auditimit.</p> <p>Për rastin e dytë dhe të tretë</p> <p>Për rastin e dytë dhe të tretë, ekipi i auditimit gjatë procesit të auditimit ka kërkuar sqarime dhe dëshmi mbështetëse nga Komuna për këto çështje. Megjithatë, as gjatë auditimit dhe as në fazën e komenteve nuk janë ofruar dëshmi që mbështesin sqarimin e dhënë. Në komentet e saj, Komuna ka deklaruar vetëm se bëhet fjalë për lëshime teknike, pa e dokumentuar këtë pretendim. Për këtë arsye, nuk ka bazë për ndryshimin e gjetjes së auditimit.</p>
---	--	---

<p>Nënshkrimi i kontratës me operatorin ekonomik të papërgjegjshëm</p>	<p>Hartimi i paramasës dhe ST është përpiluar nga njësia kërkuese ndërsa vlerësimi i ofertave është bërë nga komisioni profesional dhe objektiv për vlerësimin e ofertave. Në rastin konkret nuk janë evidentuar gabime aritmetikore nga komisioni vlerësues. Megjithatë, operatori ekonomik fitues me rastin e nënshkrimit të kontratës ka konfirmuar me shkrim se për të gjitha pozicionet ku mund të ketë devijime aritmetikore, do të realizoj punimet në tërësi sipas kontratës pa pagesë shtesë.</p>	<p>Arsyetimi i paraqitur nga Komuna nuk ndikon në ndryshimin e gjetjes, pasi çështjet e ngritura janë trajtuar tashmë në pjesën e shkakut të gjetjes. Nga verifikimi i ofertës është konstatuar se diferenca ndërmjet vlerës së ofertës dhe vlerës së korrigjuar është rreth 7%, duke tejkaluar pragun e lejuar prej +/- 2% të përcaktuar me rregullore. Megjithatë, komisioni vlerësues nuk e kishte identifikuar këtë gabim, kishte rekomanduar operatorin ekonomik për shpërblim të kontratës dhe kontrata ishte nënshkruar.</p> <p>Deklarimi i operatorit ekonomik se do t'i realizojë punimet pa pagesë shtesë nuk e ndryshon faktin se kërkesat e nenit 40 të rregullores nuk janë zbatuar gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.</p> <p>Për këtë arsye, gjetja mbetet e pandryshuar.</p>
--	--	--

<p>Fillimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratave pa sigurimin paraprak të lejeve ndërtimore</p>	<p>Njësia kërkuese ka siguruar të gjitha pëlqimet e nevojshme për të filluar procedurat përkatëse të prokurimit. Sa i përket projektit për Tregjet e Gjelbra, komuna ka aplikuar edhe në IKMT për marrjen e pëlqimit përkatës dhe tanimë IKMT e ka lëshuar këtë pëlqim ndërsa punimet janë duke vazhduar me rregull.</p> <p>Sa i përket sheshit “Xhorxh Bush” duhet sqaruar se për pjesët ku kërkohet pëlqim vetëm nga Komuna, janë siguruar pëlqimet përkatëse. Mirëpo edhe për pjesët tjera, është parashtruar kërkesa për pëlqim në IKMT. Përndryshe Komuna dhe IKMT aktualisht ndodhen në procedurë gjyqësore - konflikt administrativ pikërisht lidhur me këtë çështje. Në ndërkohë, IKMT ka larguar edhe masat për pezullimin e punimeve ashtu që punimet aktualisht po zhvillohen sipas kontratës.</p>	<p>Arsyetimet e paraqitura nga Komuna nuk i ndryshojnë faktet e konstatuara në gjetje.</p> <p>Për projektin “Ndërtimi i Sheshit Xhorxh Bush”, në kohën e nënshkrimit të kontratës nuk ishin siguruar të gjitha pëlqimet dhe kushtet e kërkuara për realizimin e punimeve. Ndërsa për projektin “Ndërtimi i Tregjeve të Gjelbra”, kërkesa për pajisje me leje ishte dorëzuar pas nënshkrimit të kontratës. Përkundër kësaj, në të dy rastet Komuna kishte zhvilluar procedurat e prokurimit dhe kishte hyrë në obligime kontraktuale pa siguruar paraprakisht dokumentacionin dhe pëlqimet e nevojshme.</p> <p>Fakti që një pjesë e pëlqimeve janë siguruar më vonë, se punimet kanë vazhduar apo se ekziston një procedurë gjyqësore lidhur me projektin, nuk e ndryshon gjendjen që ka ekzistuar në kohën e zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave. Për më tepër, pezullimi i punimeve nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve tregon se nuk ishin plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme për realizimin e projekteve.</p> <p>Për këtë arsye, gjetja mbetet e pandryshuar.</p>
---	---	---

<p>Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për lejet ndërtimore</p>	<p>Komuna pajtohet se ka pasur vonesa në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për leje ndërtimore, të cilat kanë ndikuar edhe në mosrealizimin e të hyrave dhe në nivelin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Sipas Komunës, këto vonesa kanë ardhur si rezultat i sfidave të shumta operative dhe ligjore, përfshirë mangësitë në kornizën ligjore dhe dokumentet e planifikimit hapësinor, numrin e madh të kërkesave në raport me stafin në dispozicion, mungesën e pajisjeve adekuate, si dhe procedurat e shumta paraprake që duhet të përmbushen para lëshimit të lejes ndërtimore.</p> <p>Komuna nuk pajtohet me konstatimin se vonesat kanë ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes, duke theksuar se procesi i shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave monitorohet vazhdimisht nga udhëheqësi i sektorit dhe drejtori i drejtorisë, ndërsa dokumentacioni shqyrtohet në disa nivele para miratimit përfundimtar.</p> <p>Komuna është zotuar se do të ndërmarrë masa për të reduktuar vonesat në të ardhmen.</p>	<p>Komenti i Komunës nuk e ndryshon gjetjen e auditimit. Auditimi ka konstatuar se në gjashtë rastet e testuara afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore nuk janë respektuar, me vonesa që kanë varionuar nga gjashtë muaj deri në tri vite.</p> <p>Arsyetimet e paraqitura nga Komuna lidhur me numrin e madh të kërkesave, mungesën e stafit dhe procedurat paraprake mund të kenë ndikuar në krijimin e vonesave, por nuk e ndryshojnë faktin se kërkesat nuk janë trajtuar brenda afateve ligjore. Për më tepër, pavarësisht procedurave të kontrollit dhe mbikëqyrjes të përshkruara në koment, ato nuk kanë siguruar trajtimin e kërkesave brenda afateve të përcaktuara me ligj, gjë që tregon se kontrollet e vendosura nuk kanë qenë efektive në parandalimin e këtyre vonesave.</p> <p>Për këtë arsye, gjetja mbetet e pandryshuar.</p>
--	--	--

<p>Dobësi në inventarizimin, vlerësimin e pasurisë dhe pasqyrimin e pasurisë nën 1,000€ dhe stoqeve</p>	<p>Si zyrtar i pasurisë e kamë njoftuar ZKA-në edhe Drejtoreshen e Drejtorisë së Administratës për formimin e komisioneve për inventarizim për vitin 2025, me dt.02.10.2025. Çështja e Fatures në vlerë prej 24,482.00€ e realizuar në vitin 2024. Si zyrtar i pasurisë e kam regjistru pjesen time per inventar në vlerë prej 14,841.00€, ndersa pjesa e material shpenzues i takon DEPOS, nuk ka të bëjë me mua.</p>	<p>Komenti i Komunës nuk paraqet fakte apo dëshmi që do të ndikonin në ndryshimin e konstatimeve të auditimit</p> <p>Njoftimi i zyrtarit të pasurisë i datës 02.10.2025 dëshmon se nevoja për formimin e komisioneve ishte identifikuar me kohë. Megjithatë, komisioni për inventarizim është caktuar vetëm më 30.03.2026, ndërsa komisioni për vlerësimin e pasurisë nuk është caktuar fare. Si rezultat, procesi i inventarizimit nuk është përfunduar me kohë, nuk është përgatitur raporti përmbledhës i inventarizimit dhe nuk është bërë harmonizimi i gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurisë, siç kërkohet me rregullore.</p> <p>Po ashtu, komenti konfirmon se materiali shpenzues në vlerë prej 9,641€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e stoqeve. Pretendimi se përgjegjësia i takon një njësie tjetër organizative nuk e ndryshon faktin se regjistrimi nuk ishte kryer dhe se kontrollet e brendshme nuk kanë siguruar evidentimin e plotë të stoqeve.</p> <p>Këto rrethana mbështesin konstatimin e auditimit se nuk janë zbatuar plotësisht kërkesat e Rregullores për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare dhe se mangësitë në menaxhimin dhe raportimin e pasurive dhe stoqeve vazhdojnë të përsëriten.</p> <p>Për këtë arsye, gjetja mbetet e pandryshuar.</p>
<p>Dobësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive</p>	<p>1. Çështja e transferit (projektit) në vlerë prej 5,120,000€ i realizuar gjatë vitit 2024.</p> <p>Koment: si zyrtar i pasurisë, projektin në fjalë e kamë regjistruar në bazë të realizimit të të gjitha pagesave të ekzekutuara nga Komuna e Prishtinës, por që në atë kohë ka munguar një raport nga UNDP-ja, gjë që një raport të tillë nuk e posedoj as sot.</p>	<p>Për komentin e parë</p> <p>Komenti i Komunës nuk e ndryshon gjetjen e auditimit. Sipas komentit të paraqitur, raporti nga UNDP-ja mungonte në kohën e regjistrimit dhe nuk posedohen as aktualisht.</p> <p>Për më tepër, auditimi ka konstatuar se projektet në Qendrën “Gërmia” dhe objektet e “Tulltores” nuk kishin përfunduar në tërësi dhe pasuritë</p>

2. Çështja e projektit “Arkitektit të Kryeqytetit” pagesat në vlerë totale prej 2,347,888.50€

Koment: si zyrtar i pasurisë, projektin në fjalë kam regjistruar si tërsi dhe jo si fatura individuale sepse ka qenë fundi i dhjetorit të vitit 2023, gjë që dihet fare mire se në qfarë presioni të kohës punohet dhe se sa është nr. i madhë i Transfereve në pritje për regjistrim si pasuri.

3. Çështja e projektit në bashkëfinancim me LUX Development për QK për TIK:

Koment: si zyrtar i pasurisë e kam regjistruar pjesën e pagesave të ekzekutuara nga Komuna e Prishtinës, ndërsa në mungesë të një raporti nga bashkëfinancuesit, projekti në fjalë ka mbetur ende pa u mbyllur.

Sqarim i shtesë: me dt.03.06.2026 në zyrën e drejtorit të DKA-së z.Arianit Elshani, jemi takuar me përfqësuesit e LUX Development, ku të pranishmit e pranojnë se projekti ende nuk ka përfunduar për shkak të problemeve me operatorin ekonomik i cili ka qenë i kontraktuar për projektin QK për TIK.

4. Sa i përket projekteve të mbetrura (te evidentuara) si Investim Vijim, ka prej tyre që janë të grumbulluara prej viteve të para të punës time, ka prej tyre si pasojë e mungesës së raporteve për pranim teknik (situacione të rëndësishme), ka raste kur edhe pse është bërë kërkesa në Thesar për mbyllje, ende nuk janë mbyllur, ka prej tyre që janë regjistruar në fund vitit që e dijmë fare mire të gjithë se në qfarë volumi të punëve punohet. Kur gjithë këtyre fakteve ja shtojmë edhe faktin kryesor, se si zyrtar i vetëm dhe pa ndihmën e askujt kam punuar gjatë gjithë këtyre viteve, len me kuptim se mund të ndodhin edhe gabime.

5. Ndërsa, sa i përket projekteve të regjistruara (mbyllura) para kohe, ka

përkatëse nuk ishin pranuar nga Komuna. Si rezultat, regjistrimi i shumës prej 5,120,000€ si pasuri në përdorim nuk ishte në përputhje me kërkesat për njohjen dhe regjistrimin e pasurive kapitale.

Për komentin e dytë

Komenti i Komunës nuk e ndryshon gjetjen e auditimit. Ngarkesa me punë dhe regjistrimi i kryer në fund të vitit nuk e arsyetojnë trajtimin e 15 pagesave që lidhen me projekte të ndryshme si një regjistrim i vetëm në kategorinë “investime në vijim”.

Për shkak se këto pagesa i përkasin projekteve të ndryshme dhe ndodhen në fazë të ndryshme të realizimit, ato do të duhej të regjistroheshin sipas projekteve përkatëse, me qëllim të pasqyrimit të saktë të gjendjes së investimeve dhe avancimit të secilit projekt.

Për komentin e tretë


Komenti i Komunës ofron vetëm një sqarim nga zyrtari i pasurisë, i cili nuk është mbështetur me dokumentacion apo dëshmi përkatës. Në kohën e auditimit dhe as gjatë fazës së komenteve nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme që do të mundësonin verifikimin e statusit të projektit dhe trajtimin e tij kontabël.

Për më tepër, edhe pse komenti ofron një sqarim lidhur me statusin e projektit, ai nuk është mbështetur me dokumentacion përkatës. Auditimit nuk i janë ofruar dëshmi që do të mundësonin verifikimin nëse pasuria është pranuar nga Komuna, nëse është vënë në shfrytëzim dhe nëse trajtimi i saj kontabël është në përputhje me statusin real të projektit. Në mungesë të këtyre dëshmive, deklarimi i zyrtarit të pasurisë nuk është i mjaftueshëm për të vlerësuar trajtimin e duhur kontabël të projektit.

Për komentet e katërt dhe të pestë

<p>ndodhë gjatë viteve të para të punesime, përveq që ka ndikuar mungesa e përvojës në këtë drejtim, ka ndikuar edhe mungesa e ndihmes nga kush do qoft në atë kohë, mungesa e kontrollës për të më korrigjuar - rekomanduar për përmirsime. Gjë që, viteve të fundit këto problem sa i përket regjistrimit - mbylljes te parakohshme nuk më kan ndodhë.</p> <p>Sqarim shtesë: sa i përket 14 projekteve (mostrave) të përzgjedhura si Investi Vijim, ju njoftoj se 12 prej tyre janë përmirsuar (korrigjuar). Por, nga të gjitha mostrat e përzgjedhura si Investim Vijim, pa u mbyllur kanë mbetur vetëm qështja e projektit me Lux Development për QK për TIK nuk ka përfunduar ende dhe projekti me MKRS për projektin e Stadionit të Prishtinës - bashkëfinancim me MKRS-në, mungon raporti financiar nga ana e tyre, ku pjesa e financuar nga Komuna e Prishtinës është e evidentuar.</p> <p>Ndërsa, sa i përket pasurive të regjistruara si projekte të mbyllura si situacione individuale, e që mostra kanë qenë 5 gjithësej, ju njoftoj se janë përmirsuar - korrigjuara të gjitha.</p>	<p>Komentet e Komunës nuk e ndryshojnë gjetjen e auditimit. Arsyetimet lidhur me mungesën e raporteve, projektet e trashëguara, ngarkesën me punë, mungesën e burimeve njerëzore, përvojës apo kontrolleve shpjegojnë rrethanat që kanë ndikuar në krijimin e mangësive, por nuk i eliminojnë pasaktësitë e identifikuar në regjistrimin, klasifikimin dhe përditësimin e informatave në regjistrin e pasurisë.</p> <p>Për më tepër, vetë komentet pranojnë se kanë ndodhur gabime në menaxhimin e këtyre regjistrimeve. Po ashtu, fakti që një pjesë e projekteve janë korrigjuar pas identifikimit nga auditimi konfirmon se mangësitë e raportuara kanë ekzistuar në kohën e auditimit. Korrigjimet e bëra pas auditimit janë veprime pozitive, por nuk e ndryshojnë gjendjen e konstatuar për periudhën e audituar.</p> <p>Për këtë arsye, gjetja mbetet e pandryshuar.</p>
--	---

<p>Mangësi në menaxhimin e arkëtimit të borgjeve</p>	<p>Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, duke u bazuar në kërkesën, kryesuesen e Komisioni për trajtimin dhe verifikimin e borxheve të papaguara nga personat fizik dhe juridik ndaj Komunës së Prishtinës si pasojë e pajisjes me leje ndërtimore, me referencë 14 Nr. 020/04-252336/22 dt. 17.11.2022, i miratuar nga Kryetari i Komunës, ka përcjell pranë këtij komisioni aktet administrative për caktimin e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifës për ndikimin nga rritja e densitetit të infrastrukturës (për periudhën kohore 2019-2023), dhe faturat e pagesës, të personave fizik dhe juridik, të cilët kanë marrë leje ndërtimore nga Drejtoria e Urbanizmit dhe që nuk i kanë kryer obligimet ndaj Komunës së Prishtinës, për iniciimin e procedurës përmbartimore, konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore. Bazuar në paragrafin III., të Vendimit të njëjtë, ku thuhet se, citoj: “Detyrë e komisionit është trajtimi, identifikimi dhe verifikimi i listës së personave fizik dhe juridik, të cilët kanë marrë leje ndërtimi nga Drejtoria e Urbanizmit dhe nuk i kanë paguar borgjet për këto leje ndërtimi...”, komisioni i njëjtë, disa i ka proceduar në procedurë gjyqësore dhe disa në atë përmbartimore.</p>	<p>Komenti i Komunës nuk e ndryshon gjetjen e auditimit. Edhe pse në koment është theksuar se një pjesë e rasteve janë proceduar në procedura gjyqësore dhe përmbartimore, për mostrat e testuara nga auditimi nuk janë identifikuar veprime konkrete të ndërmarra për mbledhjen e borgjeve.</p> <p>Për më tepër, në fund të vitit 2025 vazhdonin të evidentoheshin borgje të pambledhura nga lejet e ndërtimit në vlerë prej 7,456,905€, të krijuara kryesisht gjatë viteve 2008-2023. Kjo tregon se masat e ndërmarra nuk kanë siguruar mbledhjen efektive të këtyre borgjeve.</p> <p>Për këtë arsye, gjetja mbetet e pandryshuar.</p>
--	--	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës, për vitin 2025
- Pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Besëtim Bekri
Kryetari i Kryeqytetit
Data: 19.06.2026



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Fatura te Fatosi ne vlere prej 86,871€ dhe fatura Petroll Company 78,580€.
- ⁶ Pagesa në vlerë 3,861.18€ nga tatimpaguesi nr. 91964125345, e shpërndarë në kartelë financiare vlere 3,779.07€. Vlora prej 82.11€ kthehet borgj i papaguar. Pagesa në vlerë 1,323.20€ nga tatimpaguesi nr. 2191064, e shpërndarë në kartelë financiare vlere 1,301.72€. Vlora prej 21.48€ kthehet borgj i papaguar. Pagesa në vlerë 1,058.68€ nga tatimpaguesi nr. 202747, e shpërndarë në kartelë financiare vlere 1,038.35€. Vlora prej 20.33€ kthehet borgj i papaguar. Pagesa në vlerë 3,902.40€ nga tatimpaguesi nr. 1199861, e shpërndarë në kartelë financiare vlere 3,894.72€. Vlora prej 7.68€ kthehet borgj i papaguar. Pagesa në vlerë 1,856€ nga tatimpaguesi nr. 9162307920, e shpërndarë në kartelë financiare vlere 1,844.04€. Vlora prej 11.96€ kthehet borgj i papaguar.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.